

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**SOUTHEAST EUROPEAN UNIVERSITY**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**



**Punim diplome**

**Tema: “Avokati i Popullit dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë: Analizë krahasuese në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut”**

**Kandidati:**  
**Arb Përzhaku**

**Mentori:**  
**Prof. Dr. Besa Kadriu**

*Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët*

***Përgaditur nga: BA. Arb Përzhaku***

***Për mbrojtjen e shkallës Master***

***Departamenti: Administratë Publike***

***Tema: “Avokati i Popullit dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë: Analizë krahasuese në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut”***

***Mentor: Prof. Dr. Besa Kadriu***

***Mbrohet më: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .***

***Komisioni***

***1. \_\_\_\_\_ (Kryetar)***

***2. \_\_\_\_\_ (Anëtar)***

***3. \_\_\_\_\_ (Anëtar)***

***Tetovë, 2022***

## Përmbajtja

Deklerata e autorësisë	6
FALËNDERIME	7
ABSTRAKT	8
Abstract	9
АБСТРАКТ	10
HYRJE	11
Lënda e Hulumtinit	12
Qëllimi i këtij punimi:	12
Hipotezat	13
Metodologjia e punimit	13
Rëndësia e punimit	14
<b>KAPITULLI I</b>	<b>15</b>
<b>Kuptimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, gjendja dhe mbrojtja e të Drejtave të Njeriut.</b>	<b>15</b>
1. Zanafilla dhe rëndësia e Avokatit të Popullit.	15
1.1. Avokati i Popullit, përgjegjësia dhe qeverisja e mirë.	17
1.2. Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut me anë të Konventave, Kushtetutave dhe ligjeve	20
<b>Kapitulli i II</b>	<b>25</b>
<b>Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.</b>	<b>25</b>
2. Pozita Kushtetuese e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës	25
2.1. Mandati dhe roli i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.	26
2.2. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.	28
<b>Kapitulli III</b>	<b>30</b>
<b>Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.</b>	<b>30</b>
3. Pozita Kushtetuese e Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.	30
3.1. Mandati dhe roli i Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.	31
3.2. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.	33

3.3 Përvoja praktike e zyrës së Avokatit të Popullit-Sprecifikat dhe realitete të studimeve të rasteve praktike.	35
<b>KAPITULLI IV</b>	39
<b>Gjendja e të Drejtave të Njeriut dhe përdorimi i gjuhëve nga komunitet-bashkësitë jo shumicë, - në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.</b>	39
4. Të drejtat e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.	39
4.1.Përdorimi i gjuhës nga ana e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.	41
4.2.Të drejtat e etniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.	43
4.3.Përdorimi i gjuhëve nga etnitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut	47
4.4.Parashtresat individuale të Avokatit të Popullit	49
<b>Hulumtimi empirik</b>	54
<b>Rekomandimet</b>	64
<b>Përfundimet</b>	65
<b>Conclusion</b>	69
<b>Bibliografia</b>	73

## **Deklerata e autorësisë**

Unë, Arb Përzhaku student në “Universitetin e Evropës Juglindore”, Tetovë: Fakulteti i Shkencave Bashkëkohore, programi Administratë Publike, niveli Master:

*Deklaroj se punimi i titulluar “Avokati i Popullit dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë: Analizë krahasuese në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut” është punim autentik i imi dhe nuk është prezantuar më herët para ndonjë institucioni ose komisioni për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person apo nga ndonjë burim tjetër përveç rasteve të cituara ose të referuara në mënyrë të rregullt duke respektuar të drejtat e autorit në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit të Republikës së Kosovës.*

Arb Përzhaku

---

## FALËNDERIME

Falënderoj zotin që më dha jetë, shëndet, vullnet dhe mundësi për të arritur këtë moment të veçant të jetës time, sepse realizimi i këtij punimi është fryt i një pune kërkimore të gjatë, punë e cila nuk mund të realizohej pa përkrahjen e personave më të dashur.

Falënderoj pafundësisht familjen time që më ka qëndruar afër në çdo moment të jetës time dhe dëshiroj të theksoj që ndihem i bekuar për besimin, përkrahjen morale dhe financiare gjatë rrugëtimit tim akademik. Dëshiroj të falënderoj veçanërisht babin tim për përkrahjen morale ku me këshillat dhe përvojën e tij intelektuale ka luajtur një rol të madh në formimin tim fillimisht si person, pastaj si student.

Falënderoj të gjithë shoqërinë time të çmuar sepse me prezencën e tyre, vitet e studimeve i bënë më atraktive dhe ndihem me fat që ju kam.

Falënderoj mentoren time të dashur Prof. Dr. Besa Kadriu për mbështetjen, inkurajimin dhe këshillat në lidhje me realizimin e këtij punimi. Ishte nder dhe privilegj të bashkëpunoj me ju!

Gjithashtu dëshiroj të falënderoj të gjithë profesorët dhe stafin akademik të “Universitetit të Evropës Juglindore” në Tetovë për profesionalizmin dhe ngrohtësinë e tyre.

## ABSTRAKT

Ky punim me titull: ***“Avokati i Popullit dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë: Analizë krahasuese në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut”***, ka për qëllim që të analizoj Institucionin e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucion i cili ka detyrë sublimë në mbrojtjen, avancimin, mbikëqyrjen, dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Puna e këtij insitucioni e mban nën vëzhgim çdo tendencë të cilit do pushtet për të kufizuar lirinë e çdo individi, po ashtu të dhënat e këtij insitucioni paraqesin bazë në përpunimin e legjislacioneve të ndryshme të cilat garantojnë drejtësi për të gjithë në shoqëri.

E veçanta e këtij punimi është sepse këto dy shtete fqinje kanë shumë të përbashkëta për nga konteksti historik i krijimit, por edhe në aspektin normativ e juridik sepse kanë qenë brenda ombrellës së një sistemi juridik administrativ të ish-Jugosllavisë, prandaj është intriguese të shikojmë avancimin e focimit të strukturave dhe insitucioneve shtetërore të këtyre shteteve. Gjithashtu është intriguese të studiohet edhe harmonizimi i legjilacioneve të tyre karshi respektimit të drejtave të njeriut, në veçanti respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare apo të etniteteve të tjera jo shumicë, siç është në praktikën e shtetit fqinj. Respektimi i të drejtave të tyre është standard evropian dhe parakusht për synimet euro-integruese dhe euro-atlantike.

Përveç raporteve vjetore të Insitucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut e kam parë të udhës që edhe unë ta bëj këtë analizë krahasuese me qëllim që të nxis vëmendjen dhe ndërjegjësimin karshi respektimit të drejtave të njeriut sepse siç e ka theksuar edhe Komisioni i Venecias: *Çelësi i suksesit të insitucioneve të ombudspersonit, qëndron në fuqinë e tij/saj për të bindur nëpërmjet arsyes, në bazë të ligjit dhe drejtësisë.*



Fjalët kyqe: *Avokati i Popullit, komunitetet jo-shumicë, kontroll, konvent, kushtetut, ligj.*

## **Abstract**

This paper entitled: "People's Advocate and the rights of the non-majority community: Comparative analysis in the Republic of Kosovo and the Republic of Northern Macedonia", has led the analysis of the Institution of the People's Advocate in the Republic of Kosovo and the Republic of Macedonia of the North, in the institution that has the sublime duty to protect, advance, reverse, and promote human rights. The work of the institution monitors any tendency to exert power to stand on the freedom of each individual, as well as other data represent the basis in the elaboration of all the different types which guarantee everyone in society.

It is especially possible to work because these two neighboring countries have had many interests from the historical context of creation, but also in the normative and legal aspect because they were within the umbrella of an administrative legal system of the former Yugoslavia, so it is intriguing to see the advancement of focusing on the structures and man of their state. It is also intriguing to study the harmonization of their respective human-led legislatures, in the case of respecting the leadership of national or other minorities, as is the practice of the neighboring state. Respect for their rights is a European standard and a precondition for Euro-integration and Euro-Atlantic goals.

In addition to the annual reports of the Institution of the People's Advocate in the Republic of Kosovo and in the Republic of Northern Macedonia, I have seen it appropriate that I also do not make this analysis, comparing it with the one that encourages and raises awareness towards respecting the human direction that has been emphasized by the Venice Commission:

The key to the success of ombuds institutions lies in his / her power to link reason, based on law and justice.

Keywords: *People's Advocate, non-majority communities, control, convention, constitution, law.*

## АБСТРАКТ

Овој труд со наслов: „Застапник на народот и правата на мнозинската заедница: Компаративна анализа во Република Косово и Република Северна Македонија“, ја предводеше анализата на Институцијата на народниот застапник во Република Косово и Република Македонија на Север, во институцијата која има возвишена должност да ги штити, унапредува, укинува и промовира човековите права. Работата на институцијата ја следи секоја тенденција за примена на моќ да се залага за слободата на секој поединец, како и другите податоци што претставуваат основа во разработката на сите различни типови што гарантираат секого во општеството.

Посебно е можно да се работи бидејќи овие две соседни земји имале многу интереси од историскиот контекст на создавањето, но и од нормативно-правен аспект бидејќи биле во чадорот на еден административно правен систем на поранешна Југославија, па затоа е интригантно. да се види напредокот на фокусирањето на структурите и човекот на нивната држава. Исто така, е интригантно да се проучува хармонизацијата на нивните законодавни тела предводени од човекот, во случај на почитување на раководството на националните или другите малцинства, како што е практиката на соседната држава. Почитувањето на нивните права е европски стандард и предуслов за евроинтеграциите и евроатлантските цели.

Покрај годишните извештаи на Институцијата на народниот застапник во Република Косово и во Република Северна Македонија, видов дека е соодветно и јас да не ја направам оваа анализа, споредувајќи ја со онаа што ја поттикнува и подигнува свеста кон почитување на човечката насока што беше нагласена од Венецијанската комисија: Клучот за успехот на институциите на народниот правобранител лежи во неговата / нејзината моќ да ги поврзе разумот, заснован на право и правда.

Клучни зборови: *Застапник на народот, немнозински заедници, контрола, конвенција, устав, право.*

## **HYRJE**

Punimi shkencor me temë “*Avokati i Popullit dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë: Analizë krahasuese në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut*” paraqet një qasje shkencore të detajuar në mes praktikave të dy vendeve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke marrë për bazë të analizës funksionimin e Avokatit të popullit dhe trajtimin e komuniteteve jo-shumicë, sepse të drejtat e barabarta politike dhe qytetare për të gjithë personat pa marrë parasysh dallimet nacionale, ngërthejnë në vete vlera sublimе por ndonjëherë këto nuk janë të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të etniteteve jo shumicë. Fillimisht duhet të ekzistojë njohja kushtetuese juridike dhe njohja reale e tyre e pastaj të bëhet garantimi aktiv dhe efektiv i të drejtave me anë të mbrojtjes nga mekanizmat e veçantë institucional.

Në praktikata e shumë sistemeve të avancuara, apo thënë ndryshe të shteteve të zhvilluara, zyra e Avokatit të Popullit paraqet një nga autoritetet me vlerë të veçantë, sidomos për faktin që ky institucion i ndarjes së vlerave të mirëfillta të demokracisë, apo i mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, vazhdon të kultivojë mbarëvajtjen e proceseve brenda autoriteteve të cilat e ndajnë drejtësinë. Avokati i Popullit vlerëson para së gjithash ligjshmërinë, por edhe oportunitetin e punës së organeve dhe individëve që disponojnë me autorizime publike.

Puna e këtij dikasteri të drejtësisë ndonëse dallon nga një vend në vendin tjetër ajo i ka

edhe tiparet e përbashkëta, dallimi ndoshta mund të qëndrojë tek emërtimi, struktura, burimet njerëzore, rregullimi kushtetues-ligjor etj, por detyra themelore e Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut mbetet e njëjtë. Pra, me anë të kësaj teze shkencore jam munduar t'i vë në pah ngjashmëritë dhe dallimet dhe të bëj krahasimin në mes të zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës dhe Avokatit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **Lënda e Hulumentit**

Hulumtimi i propozuar ka për qëllim që të bëjë një çasje praktike për institucionin e Avokatit të Popullit, rolin dhe rëndësinë e tij si mbrojtës dhe përgjegjës i respektimit të të drejtave të njeriut në Administratën Publike. Dhe pasi që zhvillimi i së drejtës administrative në shtetin e Republikës së Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut ka shumë karakteristika të përbashkëta dhe të ngjashme, si për nga konteksti historik i krijimit, por edhe në aspektin normativ e juridik, kjo për të vetmen arsye sepse gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit kushtetues-juridik, kanë qenë brenda ombrellës së sistemit juridik administrativ të ish-Jugosllavisë. (Kosova si njësi federale me status të autonomisë politike - territoriale, ndërsa Maqedonia si njësi federale në formë të Republikës).

Në temën e magistraturës me titull “Avokati i Popullit dhe të drejtat e komuniteteve joshumicë: Analizë krahasuese në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Veriut”, do të mundohem të analizojë institucionin e Avokatit të Popullit në shtetet përkatëse në mënyrë që ti informojë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut rreth Institucionit të Avokatit të Popullit, detyra e të cilit është mbrojtja themelore e të drejtave të qytetarëve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, të drejta të cilat janë të garantuara që nga

momenti i lindjes së tyre nga puna joligjore, e parregulltë dhe joefikase e organeve të administratës shtetërore.

### **Qëllimi i këtij punimi:**

Analiza e institucionit të Avokatit të Popullit dhe roli i tij në respektimin e të drejtave të njeriut.

Studim të raporteve vjetore gjatë viteve të fundit dhe përmes metodës krahasimore do të bëj krahasimin e ankesave dhe rasteve në shtetet përkatëse.

Të shërbej si material për studiuesit e ardhshëm në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht në fushën e të drejtave të komuniteteve dhe etniteteve jo shumicë.

Përfundime të rekomandimeve të ndryshme për rritjen e efikasitetit të punës së Administratës Publike dhe Avokatit të Popullit.

### **Hipotezat**

Pasi që hipoteza është hapi i parë i hulumtimit shkencor. Unë do të parashtroj disa hipoteza të cilat do të trajtoj në vazhdim.

#### **Hipoteza kryesore:**

Institucioni i Avokatit të Popullit është parakusht për funksionimin një administrate publike transparente dhe efektive.

#### **Hipotezat e veçanta:**

Dallimet Juridiko - kushtetuese me qasje komparative në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Roli i Avokatit të Popullit i rëndësishëm në funksionimin dhe efikasitetin e administratës publike.

Roli i institucioneve ndërkombëtare ka ndikim në punën e Avokatit të Popullit.

Besueshmëria e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## **Metodologjia e punimit**

Për përgaditjen e kësaj teme të magjistraturës është i nevojshëm përdorimi i teknikave dhe metodave të ndryshme hulumtuese shkencore, disa nga metodat më të rëndësishme që do t'i përdori janë: metoda historike, metoda krahasimore, metoda përshkruese dhe analiza. Përveç këtyre aspekteve metodologjike do të përdoret anketa dhe intervista, si instrumente matëse. Në vijim, këtë proces do të mundohem ta pasuroj me informacione të konsultës paraprake me ekspert të ndryshëm nga fusha administrative dhe kushtetuese.

Pas grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave nga përdorimi i metodave do të nxirren konkluzione në lidhje me rolin, punën dhe funksionimin efikas të zyrës së Avokatit të Popullit dhe mundësinë e rritjes së efikasitetit të punës së administratës publike përmes kontrollit nga Avokati i Popullit.

## **Rëndësia e punimit**

Tema e punimit është relevante dhe aktuale sepse do të cekën disa segmente të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt apo jo të drejtpërdrejt i prekin të drejtat e qytetarëve, gjithashtu është pasqyrë e perceptimit të funksionimit të administrimit publik dhe Avokatit të Popullit i cili në mënyrë efektive dhe të paanshme vepron, alarmon dhe sugjeron për gjendjen dhe jep rekomandime të përgjithshme përmes të cilave qytetarët tentojnë t'i realizojnë të drejtat e tyre që janë të garantuara me ligj dhe Kushtetut.

### **Rëndësia teorike e punimit:**

Teza e magjistraturës do të ketë një përmbledhje teorike të rolit të Instutucionit të Avokatit të Popullit kundrejt respektimit të të drejtave të njeriut në Ballkanin Perëndimor, respektivisht në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### **Rëndësia praktike e punimit:**

Pasi që diskriminimi edhe më tutje është prezent në shoqëri, kjo tezë do të shërbej si referencë për studiuesit e ardhshëm të cilët synojnë të permirësojnë standardin jetësor të individëve, gjithashtu do të shërbejë si krahasim i punës së zyrës së Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës dhe zyrës së Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sepse edhe më tutje është evidente mungesa e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në organet shtetërore, të cilat janë të thirrura të zbatojnë ligjet dhe t'u krijojnë mundësi qytetarëve për të zgjidhur problemet e tyre, me çka edhe do të shtonin besimin e në organet shtetërore dhe në shtetin ligjor.

## KAPITULLI I

### Kuptimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, gjendja dhe mbrojtja e të Drejtave të Njeriut.

#### 1. Zanafilla dhe rëndësia e Avokatit të Popullit.

Zyrtarë me detyra të ngjashme me atë të ombudsmanit modern janë parë në kultura të ndryshme gjatë historisë.<sup>1</sup> Sidoqoftë, rrënjët moderne të ombudsmanit gjenden në “*justitieombudsmannen*” suedeze (avokat i drejtë) i krijuar në 1809.<sup>2</sup> Pas një disfatë ushtarake nga Rusia në vitin 1709, mbreti suedez, Charles XII, iku në Turqi për disa vite. Si rezultat i mungesës së gjatë të monarkut, administrata në Suedi u përkeqësua. Në vitin 1713 mbreti caktoi një përfaqësues për të monitoruar sjelljen e administratës dhe gjyqësorit suedez, dhe emëroi zyrtarin “*Justitiekanslern*” (Kancelari i Drejtësisë) në vitin 1719. Nëse zbulonte një shkelje të ligjit ose sjellje të tjera të gabuara, Justitiekanslern u autorizua të fillonte procedurat ligjore kundër zyrtarit të pabindur. Ky ishte dhe është një emërim ekzekutiv, pasi Kancelari i Drejtësisë vazhdon të ekzistojë si “Ombudsman i Qeverisë”.<sup>3</sup> Sidoqoftë, midis viteve 1766 dhe 1772, (*Riksdag* ose parlamenti) morën përsipër funksionin e zgjedhjes së Kancelarit të Drejtësisë, me monarkun që rimerr këtë fuqi në vitin 1772.<sup>4</sup> Pasi Mbreti u rrëzua në vitin 1809, u miratua një Kushtetutë e re e cila e ndau pushtetin midis kurorës dhe parlamentit, duke i dhënë këtij të fundit aftësinë për të vendos disa kontrole mbi ushtrimin e pushtetit ekzekutiv.<sup>5</sup> Kushtetuta e vitit 1809 përfshiu një institucion të ri – “*Avokatin e drejtë*” - të emëruar nga parlamenti me kompetencat për të mbikëqyrur administratën publike dhe gjyqësorin dhe për të ndjekur penalisht ata që nuk

---

<sup>1</sup> Ngjashmëri të tilla janë gjetur në sistemet romake, kineze, islame dhe spanjolle (Aragon), shih J.M. Mas i Solench, *El Sindic de Greuges de Catalunya* (Barcelona: Sfindic de Greuges de Catalunya, 1995) në I66-I67; V. Pickl, “Rrënjët Islame të Sistemeve të Ombudsmanit” (1987) 6 *Omb. J. IOI*; U. Lundvik, “*Sondazh i shkurtër i historisë së ombudsmanit*” (1982) 2 *Omb. J. 85*.

<sup>2</sup> Shih C. Ekhlundh, “*Sistemi Parlamentar Suedez i Avokatit të Popullit*” në Komisionet për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrat e Avokatit të Popullit, shënimi supra I në 423; B. Wieslander, *Ombudsmani Parlamentar në Suedi* (Fondacioni Qendror i Bankës së Suedisë, 1994); U. Lundvik, “*Suedia*” në *International Manual i Avokatit të Popullit: Anketat e Vendeve*, shënimi i parë I në I79; W. Gellhom, “*Suedezya Justitieombudsman*” (1965) 75 *Yale Law J. I*.

<sup>3</sup> Shih <[www.jo.se](http://www.jo.se)>, “*Historia*”.

<sup>4</sup> Wieslander, shënimi supra I7 në I4. Pronat ishin të përbëra nga aristokracia, kleri, fermerët dhe qytetarët.

<sup>5</sup> El-Vehab, shënimi i sipërm I8 në 23.



arrinin të përmbushin detyrat e tyre zyrtare.<sup>6</sup>

Ndërsa institucioni evoluoi, ai ndryshoi nga thjesht të qenit një monitorues legjislativ, në një proces të drejtuar nga ankesat publike. Ideja e ombudsmanit nuk u përhap përtej Suedisë deri në fillim të shekullit XX kur Finlanda e pavarësuar miratoi “zyrën” në Kushtetutën e saj të vitit 1919.<sup>7</sup>

Dy qarqe tjera skandinave e themeluan zyrën në mënyrë të konsiderueshme më vonë - Danimarka në vitin 1953 Kushtetuta (ombudsmani u emërua në 1955) dhe Norvegjia në 1962 (ombudsmani i emëruar në vitin 1963). Popullariteti i ombudsmanit të sektorit publik u përshpejtua në vitet 1960 dhe, siç u vu re, ishte “zyra” e versionit danez dhe norvegjez që u miratua në kombe të tjera.

Gjatë dyzet viteve të fundit, modeli është miratuar nga shumica e anëtarëve të Commonwealth. Zelanda e Re ishte vendi i parë i Commonwealth që krijoi një ombudsman në vitin 1962. Duke filluar nga mesi i viteve 1960, shumë pjestarë të tjerë të Commonwealth në Amerikë, Afrikë, Azi dhe në rajonin e Paqësorit kanë krijuar ombudsmenë klasik ose ombudsmenë hibridë.<sup>8</sup>

---

<sup>6</sup> Wieslander, shënimi supra I7 në II-I4. Ombudsmani i parë u emërua në 1810. Nën Suedinë sistemi ligjor, autoritetet administrative kanë pavarësi të konsiderueshme të veprimit nga dega ekzekutive e qeverisë dhe ministrat e qeverisë nuk janë përgjegjës për sjelljen e departamenteve ose zyrtarëve të qeverisë, Eklundh, shënimi i sipërm I7 në 423-424. Në periudhën bashkëkohore, fuqia për të ndjekur penalisht nuk ushtrohet shpesh.

<sup>7</sup> Avokati i Popullit u emërua në vitin 1920. Finlanda ishte nën sundimin rus derisa shpalli pavarësinë e saj në dhjetor 1917. Shih p.sh. Rasti i Aaland Islands '(1920) L.N.O.J. Furnizim Special (Nr. 3) 3 (Finlanda nuk u bë një shtet me një qeveri në kontroll të territorit të saj deri pasi që përfundoi konflikti civil në maj 1918); T. Modeen, "Ombudsmani finlandez: Rasti i parë i të huajve Pritja e Zyrës Suedeze të Avokatit të Popullit "(1981) 1 Omb. J. 41.

<sup>8</sup> Tanzania (Komisioni i Përhershëm i Hetimit, 1966, i zëvendësuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Good Governance, 2001, në veprim 2002), Guajana (Ombudsman, 1966, në operacion 1967), Mbretëria e Bashkuar (Komisioneri Parlamentar për Administratën, 1967), Mauritius (Ombudsman, 1967-1968, filloi aktivitetet në 1970), disa zyra të nivelit shtetëror në Indi (Lok Ayukta, com mencing in 1971, in operation 1972), Australia (duke filluar në nivelin shtetëror në 1972, Commonwealth Avokati i Popullit në 1976, filloi operacionet në 1977), Fixhi (Ombudsman, 1970, emëruar 1972), Zambia (Komisioni për Hetimet, 1974), Papua Guinea e Re (Komisioni i Ombudsmanit, 1975), Nigeria (Komisioni i Ankesave Publike, 1975, gjithashtu në shtetin Ievel), Trinidad dhe Tobago (Ombudsman, 1976), Xhamajka (Ombudsmani Parlamentar, 1978, i zëvendësuar nga Mbrojtësi Publik, 2000), Shën Lucia (Komisioneri Parlamentar, 1978, filloi operacionet në 1981), Gana (Ombudsman, 1980, i zëvendësuar nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësinë Administrative, 1992, në funksion 1993), Ishujt Solomon (Ombudsman, 1980), Zimbabve (Ombudsman, 1982), Barbados (Ombudsman, 1980, filloi aktivitetet në 1987), Sri Lanka (Komisioneri Parlamentar për Administratën, 1981), Pakistan (Wafaqi Mohtasib, 1983), Uganda (Inspektorati i Qeverisë, 1985, filloi aktivitetet në 1986), Ishujt Cook (Ombudsman, 1985), Samoa (Komesina o Sulfufaiga, 1988, në

Avokati i popullit gjithashtu u krijua gjithnjë e më shumë dhe u përshtat në vende të tjera, duke filluar në të njëjtën periudhë kohore, dhe duke vazhduar deri më sot me krijimin e institucionit i cili njihet më gjerësisht. Shtetet që kanë krijuar një ombudsman kanë qenë të ndryshme nga demokracitë e krijuara të cilat reformojnë strukturat e tyre qeverisëse në shtete të ndryshme gjatë fazave të demokratizimit. Për shembull, ombudsmenët (*mediateurs* ose ndërmjetësuesit) janë krijuar në: pesë shtete dhe dy varësi në SHBA (duke filluar në 1969),<sup>9</sup> Francë (1973), Itali (në shumicën e rajoneve dhe provincave duke filluar nga Toskana, 1974), Austria (1977), Holanda (1981, në veprim 1982), Irlanda (1980, filloi operacionet 1984), Islanda (1988), Grenlanda (1994, në funksionim 1995), Korea e Jugut (1994), Belgjika (zyra federale në vitin 1995, gjithashtu zyra e komunitetit Flamand dhe zyret e komunitetit Walloon), kombet tjera frankofone në Afrikë (zyra e *Mediateur* ndërmjetësuesit) dhe Maroku (2002). Avokati i Popullit hibrid është krijuar në shumë shtete të tjera.<sup>10</sup>

### 1.1. Avokati i Popullit, përgjegjësia dhe qeverisja e mirë.

Së pari, duhet të theksohet se pavarësisht nga karakteristikat e tyre të ngjashme strukturore, jo të gjitha institucionet e shqyrtuara në studim zyrtarisht quhen "*Ombudsman*". Titulli "*Ombudsman*" u përdor nga ligjvënësit në një numër vendesh të "Commonwealthit" dhe

---

operacioni 1990), Namibia (Ombudsman, 1990), Qipro (Komisioneri për Administratën, filloi aktivitetet në 1991), Sishel (Ombudsman, 1993, filloi aktivitetet, 1994), Lesoto (Ombudsman, 1993), Malawi (Ombudsman, 1994, filloi aktivitetet 1995), Botswana (Ombudsman, 1995, në operacion Dhjetor 1997), Antigua dhe Barbuda (Ombudsman, 1981, filloi aktivitetet në 1995), Afrika e Jugut (Mbrotjësi Publik, 1995), Malta (Ombudsman, 1995), Vanuatu (Ombudsman, 1995), Belize (Ombudsman, 1994, filloi aktivitetet në 1999), Gambia (Ombudsman, 1999), Sierra Leone (Ombudsman, Kushtetuta 1991, ligji 1997, në veprim 2002). Një person i Ombuds-it operoi në Swaziland 1983-1987. Avokati i Popullit për Territorin Britanik Jashtë Gjibraltari u emërua në 1999 dhe Ombudsmani i Bermudës u përfshi në ndryshimet kushtetuese të vitit 2003. Në Bangladesh, legjislacioni u konsiderua në vitin 2003 për një ombudsman. Në vitin 2003, Draft kushtetuta e Kenisë parashikonte një ombudsman. Shih p.sh. J. Hatchard, National Human Institutionet e të Drejtave në Commonwealth: Drejtoria, edicioni 3d. (Londër: Sekretariati i Komonuelthit, 1998); J. Hatchard, "Disa Reflektime mbi RoJe të Komonuelthit në Zhvillimin e Institutionet Kombëtare "(Pranvera 1999) 25 Commonwealth Law Bull. 64 në Shtojcën I; Ndërkombëtare Institutit i Ombudsmanit, Drejtoria 2003 (Edmonton: Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit, 2003).

<sup>9</sup> Hawaii (1967, në operacion 1969), Nebraska (1969, në operacion 1971), Iowa (1970 ekzekutiv, 1972 ombudsman legjislativ), Alaska (1975), Arizona (1996), Porto Riko (1977) dhe Guam (1978, në operacioni 1979).

<sup>10</sup> Linda C. Reif, "*The Ombudsman, Good Governance and the International Human Rights System*", fq. 7.

gjithashtu u miratua në një numër vendesh të tjera.

Rrënja e termit “Ombusman” rrjedh nga fjala e vjetër “omud” që do të thotë “përgjegjësi”, “detyrë”, “komision”.<sup>11</sup> Nga kjo fjalë duke i shtuar prapashtesën “man”, ka rrjedhur termi “ombudsman”, që do të thotë komisioner, menaxher, përgjegjës.<sup>12</sup> Më tej, fjala suedeze *ombudsman* është përdorur për të emëruar një person detyra e të cilit ishte të kujdeset për interesat e dikujt tjetër. Në gjenezën e vet, ombudsmani është institucion që për herë të parë u paraqit në Suedi.<sup>13</sup> Ai u krijua në fillim të shekullit XIX me Kushtetutën e viti 1809, kushtetutë kjo e bazuar në balancën e pushteteve ndërmjet mbretit dhe parlamentit, në mënyrë që të krijohej një kontroll parlamentar më i fortë mbi pushtetin ekzekutiv.<sup>14</sup> Në luftërat postfeudale midis Mbretit të atëhershëm suedez Gustav Adolf IV dhe parlamentit, si përfaqësues i popullit formohet *justitieombudsman*, që do të thotë përfaqësues i parlamentit për çështje të qytetarëve, Ombudsmani ka qenë përfaqësues special i parlamentit i cili ka qenë i detyruar të përcjell nga ana e mbretit dhe administratës si zbatohen ligjet të cilat parlamenti suedez i ka miratuar.<sup>15</sup>

Nëpër shumë vende të botës, njëra nga format më të veçanta të kontrollit të administratës realizohet me institucionalizmin e ombudsmanit, institucion i cili është i lidhur drejtpërsëdrejti me idenë e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nga puna e parregullt, e paligjshme dhe jo efikase e organeve të administratës. Ky institucion zhvillohet kryesisht në ato vende të cilat kanë sistem parlamentar, ose në vendet ku kontrolli mbi punën e administratës nuk është siguruar si duhet. Avokati i Popullit veprimtarinë e zhvillon në kuadër të kushtetutës dhe ligjit, por edhe në kuadër të konventave dhe akteve ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut. Gjatë kryerjes së detyrës Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, përgjegjësisë, objektivitetit, efikasitetit, papërcaktueshmërisë partiake ose fetare dhe pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare apo bindjen fetare ose politike, racën, gjininë etj.

Sipas kornizës legislative të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, avokatët e popullit,

---

<sup>11</sup> *New short Oxford English Dictionary*.

<sup>12</sup> Ermir Dobjani, “*E drejta Administrative I*”, Tiranë, 2007, fq. 394.

<sup>13</sup> Kadri Kryeziu, “*E drejta administrative*”, Prizren, 2019, fq. 233.

<sup>14</sup> A. Sokoli, “*E drejta administrative*”, Prishtinë, 2014, fq. 326.

<sup>15</sup> Donald Rowat, “*The ombudsman, Citizens Defender*”, London 1965, cituar sipas Stevan Lilic, Upravano pravo, Beograd, 1998, fq. 541.

zgjidhen nga organi më i lartë ligjdhënës (kuvendi) duke qenë edhe përgjegjës para tyre.<sup>16</sup> Natyra unike e institucioneve të ombudsmanit do të thotë që në aspekte të rëndësishme ndryshon nga të gjitha organet tjera shtetërore. Ombudsmani nuk është as gjykatë dhe as agjenci administrative. Në fakt ai nuk ushtron ndonjë pushtet politik në kuptimin e zakonshëm, por gjithsesi ai ushtron pushtet kontroll në marrëdhëniet që ka me administratën publike. Mund të konstatohet se kontrolli i administratës nga ana e ombudsmanit është kontroll *sui generis* (i llojit të veçantë) që paraqet një kombinim të kontrollit politik dhe juridik të punës së administratës për t'u tejkaluar mangësitë e formave ekzistuese të kontrollit administrativ dhe gjyqësor të punës së administratës. Kontrolli i ombudsmanit mbi administratën është kontroll që përmban veçori të kontrollit juridik (p.sh. fillimi i procedurës siç mund ta bëjë prokurori publik). Kontrolli i ombudsmanit mbi administratën ka karakteristika të kontrollit politik të punës së administratës (p.sh hapjen e shqyrtimit parlamentar mbi përgjegjësinë e eprorit (ministrit) që udhëheq me ndonjë organ të administratës shtetërore.<sup>17</sup>                      Funksionet themelore të ombudsmanit janë: që t'i hulumtojë të gjitha rastet e shkeljes së të drejtës dhe ligjeve, për të cilat merr vesh (kuptohen apo zhvillohen gjatë procesit të caktuar administrativ) ose për të cilat i drejtohen qytetarët, që të udhëheq procedurën dhe të ndjek para gjyqit çdo funksionar i cili në ushtrimin e detyrave të veta nga favorizimi, nepotizmi, korrupsioni ose për çfardo motivi tjetër që e shkel ligjin dhe lë anash përgjegjësinë e vet, që të vlerësojë të gjitha aktet juridike dhe aktgjykimet e gjykatave supreme dhe që të ndjek, bile edhe gjyqtarët më të lartë, nëse konsideron se kanë nxjerrë aktgjykim të padrejtë, që ti paraqesë raport kuvendit dhe t'i tregojë për dobësitë e ligjeve dhe t'i propozojë ndryshimet dhe shtesat, apo nxjerrjen e ligjeve të reja etj.<sup>18</sup> Ombudsmani vlerëson para së gjithash ligjshmërinë dhe oportunitetin e nëpunësve që punojnë me autorizime publike, ku dëgjon, udhëzon, tregon, rekomandon dhe ndikon. Ai gjithashtu bashkëpunon me organizata dhe ekspertë të dalluar.

Funksioni i Ombudsmanit përmban edhe një komponentë psikologjike pozitive, sepse edhe atëherë kur ankesa refuzohet, ankuesi ndjehet i kënaqur sepse pa i'u ekspozuar shpenzimeve të mëdha dikush e ka dëgjuar, i ka kushtuar vëmendje dhe është angazhuar rreth

---

<sup>16</sup> Bajram Pollozhani, Ermir Dobjani, Esat Stavileci, Lazim Salihu, "E Drejta Administrative" - Aspekte krahasuese, Shkup, 2010, fq. 188.

<sup>17</sup> Kadri Kryeziu, "E drejta administrative", Prizren, 2019, fq. 234.

<sup>18</sup> Esat Stavileci, "Hyrje në shkencat administrative", Prishtinë, 1997, fq. 128.

problemeve të tij. Ky faktor psikologjik është shumë i rëndësishëm – ai shpie gjer tek humanizmi i raporteve midis administratës dhe qytetarëve, e edhe më shumë në shembjen e barrierave midis tyre.<sup>19</sup>

## **1.2. Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut me anë të Konventave, Kushtetutave dhe ligjeve**

Sa i përket çështjes së njohjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore ka tërhequr vëmendjen e shumë filozofëve, teologëve, politikanëve, juristëve etj. Si kategori juridike, të drejtat e njeriut janë paraqitur me krijimin e shteteve dhe rregullave të para juridike, kurse shtytje më të madhe u kanë dhënë revolucionet borgjeze, të cilat i kanë proklamuar si ideale të përbashkëra “lirinë, vëllazërinë dhe barazinë”. Pikërisht revolucionet borgjeze kanë inspiruar Ligjin për të Drejtat (Bill of Rights) të vitit 1689, Dekleratën për Pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të vitit 1776 dhe Dekleratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789, të cilat i kanë vënë standardet më të përgjithshme të të drejtave të njeriut.<sup>20</sup>

Deri atëherë, respektimi i të drejtave të njeriut ishte përgjithësisht më tepër ideal sesa realitet. Mjafton të përmendet këtu sistemi skllavopronar, në të cilin masat e gjera (robërit) jo vetëm që nuk gëzonin barazi, por trajtoheshin si sende që pronari (skllavopronari) ka mundur t’i shiste, këmbente madje edhe t’i vriste. Shprehje e kësaj është e thëna e Aristotelit se skllavi është “njëfar sendi i gjallë”.<sup>21</sup>

### **Instrumentet Kryesore Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe organet e tyre monitoruese:**

Ekzistojnë 9 instrumente kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Secili prej

---

<sup>19</sup> Ana Pavlova – Daneva, Ombudsman, Shkup, 2000, fq. 32.

<sup>20</sup> Zejnullah Gruda, “Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”, Prishtinë, 2010, fq.3.

<sup>21</sup> Aristoteli, “Politika”, Libri i parë, Kapitulli i dytë, 4.

këtyre instrumenteve ka krijuar një komitet ekspertësh për të monitoruar zbatimin e dispozitave të traktatit nga shtetet palë të tij. Disa nga traktatet përmbushen me protokolle opsionale që kanë të bëjnë me shqetësime të veçanta, ndërsa Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës krijon një komitet ekspertësh.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e miratuar më 21 Dhjetor 1965 - Monitorohet nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD) i cili është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor nga shtetet palë të tij.<sup>22</sup>

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i miratuar më 16 dhjetor 1966 - Komiteti për të Drejtat e Njeriut është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nga shtetet palë të tij.<sup>23</sup>

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore më 16 dhjetor 1966 - Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR) është organi i 18 ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga shtetet palë të tij.<sup>24</sup>

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave më 18 dhjetor 1979 - Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.<sup>25</sup>

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese më 10 Dhjetor 1984 - Komiteti Kundër Torturës (CAT) është organi i 10 ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese nga shtetet palë të saj.<sup>26</sup>

---

<sup>22</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CERD/Pages/CERDIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:44.

<sup>23</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CCPR/Pages/CCPRIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:45.

<sup>24</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CESCR/Pages/CESCRIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:46.

<sup>25</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CEDAW/Pages/Introduction.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:46.

<sup>26</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CAT/Pages/CATIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:55.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve më 20 nëntor 1989 - Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) është organ i 18 ekspertëve të Pavarur që monitoron zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve nga shtetet palë të tij. Ai gjithashtu monitoron zbatimin e dy Protokolleve Opsionale të Konventës, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura dhe shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve.<sup>27</sup>

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre më 18 dhjetor 1990 - Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (CMW) është një organ ekspertësh të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre nga ana e tij Palët shtetërore. Ai mbajti sesionin e tij të parë në Mars 2004.<sup>28</sup>

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar më 20 dhjetor 2006.<sup>29</sup>

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara më 13 dhjetor 2006 - Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) është organ i ekspertëve të pavarur i cili monitoron zbatimin e Konventës nga shtetet palë. Të gjitha shtetet palë janë të detyruara t'i paraqesin Komitetit raporte të rregullta se si zbatohen të drejtat. Komiteti shqyrton secilin raport dhe do të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme mbi raportin që mund të konsiderojë të përshtatshme dhe do t'ia përcjellë ato shtetit palë në fjalë.<sup>30</sup>

Protokoll Fakultativ i Paktit për të Drejtat Ekonomike, Kulture dhe Sociale më 10 Dhjetor 2008 - Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulture (CESCR) është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulture nga shtetet palë të tij. Komiteti u krijua sipas Rezolutës ECOSOC 1985/17 të 28 majit 1985 për të kryer funksionet e monitorimit të caktuar Këshillit Ekonomik dhe Social

---

<sup>27</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:57.

<sup>28</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CMW/Pages/CMWIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 12:58.

<sup>29</sup> Shih: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/coreinstruments.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:00.

<sup>30</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/QuestionsAnswers.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:07.

të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) në Pjesën IV të Paktit.<sup>31</sup>

Protokoll Fakultativ i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike më 16 Dhjetor 1966 - Komiteti për të Drejtat e Njeriut është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nga palët shtetërore të tij. Shtetet duhet të raportojnë fillimisht një vit pas aderimit në Pakt dhe pastaj sa herë që Komiteti e kërkon (zakonisht çdo katër vjet). Komiteti shqyrton çdo raport dhe i drejton shqetësimet dhe rekomandimet e tij shtetit palë në formën e "vëzhgimeve përfundimtare".<sup>32</sup>

Protokolli i Dytë Opsional i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, që synon heqjen e dënimit me vdekje më 15 dhjetor 1989 - Komiteti për të Drejtat e Njeriut është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nga palët shtetërore të tij.<sup>33</sup>

Protokoll Fakultativ i Konventës për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave më 10 Dhjetor 1999 - Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është organ i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Komiteti CEDAW përbëhet nga 23 ekspertë për të drejtat e grave nga e gjithë bota.<sup>34</sup>

Protokoll opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve për pjesëmarrjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura më 25 maj 2000 - Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) është organi i 18 ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve nga shtetet palë të tij. Ai gjithashtu monitoron zbatimin e dy Protokolleve Opsionale të Konventës, për pjesëmarrjen e fëmijëve në konflikte të armatosura dhe shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve. Më 19 Dhjetor 2011, Asambleja e Përgjithshme e OKB -së miratoi një Protokoll të Tretë Opsional mbi një procedurë komunikimi, i cili do t'i lejojë fëmijët individualë të paraqesin ankesa në lidhje me shkeljet specifike të të drejtave të tyre sipas

---

<sup>31</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CESCR/Pages/CESCRIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:08.

<sup>32</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CCPR/Pages/CCPRIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:10.

<sup>33</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CCPR/Pages/CCPRIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:16.

<sup>34</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CEDAW/Pages/Introduction.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:16.



Konventës dhe dy protokolleve të saj të parë opsionalë. Protokollin hyri në fuqi në Prill 2014.<sup>35</sup>

Protokollin Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve mbi një procedurë komunikimi më 19 dhjetor 2011 - Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) është organi i 18 ekspertëve të Pavarur që monitoron zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve nga shtetet palë të tij.<sup>36</sup>

Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese më 18 Dhjetor 2002 - Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese ("SPT") është një lloj i ri i organit të traktatit në sistemin e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Ai ka një mandat parandalues të fokusuar në një qasje novatore, të qëndrueshme dhe proaktive për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. SPT filloi punën në shkurt 2007.<sup>37</sup>

Protokoll Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara më 12 Dhjetor 2006 - Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) është organ i ekspertëve të pavarur i cili monitoron zbatimin e Konventës nga shtetet palë.<sup>38</sup>

Numri më madh i kushtetutave aktuale, që janë nxjerrë pas Luftës së Dytë Botërore, përmbajnë dispozita me të cilat diskriminimi ndalohet shprehimisht. Një studim krahasues (komparativ) tregon se të këtylla janë 90% e kushtetutave të nxjerra në vitet 1949-1957, 78.6% të kushtetutave të nxjerra prej vitit 1958-1966 dhe 81% të kushtetutave të nxjerra në vitet 1967-1975.<sup>39</sup> Nga kjo e dhënë, megjithatë, nuk duhet nxjerrë konkluzion të gabuar, se kushtetutat që nuk kanë dispozita të këtylla lejojnë diskriminimin, por përkundrazi se fjala është më tepër për kushtetuta të nxjerra shumë më herët ose për kushtetuta të vendeve që nuk e njohin problemin e diskriminimit.<sup>40</sup>

Njëra ndër veçoritë e së drejtës kushtetuese është se rregullat e saj nuk përmbajnë sanksione për shkeljen e tyre. Mirëpo, meqë kushtetuta është ligj suprem brenda shtetit, të gjitha

---

<sup>35</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIndex.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:18.

<sup>36</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 1:29.

<sup>37</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/OPCAT/Pages/OPCATIntro.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 2:03.

<sup>38</sup> Më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/QuestionsAnswers.aspx> çasja e fundit më datën 05.09.2021 në ora 2:05.

<sup>39</sup> Dr. Katarina Tomasevski, Kompravni prisup istrazivanju jugoslovenske koncepcije prava coveka, JRMP-1-9/1982, str. 24.

<sup>40</sup> Zejnullah Gruda, "Mbrotjja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut", Prishtinë, 2010, fq. 181.

ligjet e tjera që nxirren në bazë të saj duhet të jenë në përputhje me tekstin dhe frymën e saj. Ligjet e tjera janë ato që precizojnë shumë më detajisht të drejtat e detyrat dhe mënyrën e sjelljes së subjekteve. Disa nga këto ligje (*lex specialis*) parashohin sanksione për ata që i shkelin. Kështu, ndalimin e diskriminimit e parasheh kushtetuta, por dënimin e atyre që sillen në kundërshtim me të duhet ta sigurojë ligji penal.<sup>41</sup>

## Kapitulli i II

### Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.

#### 2. Pozita Kushtetuese e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion të pavarur kushtetues.<sup>42</sup> Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.<sup>43</sup> Funksionin e tij Avokati i Popullit e ushtron në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit shërben si mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: autoritetet publike), dhe si mekanizëm kombëtar për parandalimin e torturës dhe të trajtimit e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.<sup>44</sup> Gjithashtu, në bazë të Ligjit mbi Barazinë Gjinore<sup>45</sup> dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi,<sup>46</sup> ai është i ngarkuar me detyrën për trajtimin e

---

<sup>41</sup> Po aty, fq. 184.

<sup>42</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Kapitulli XII, nenet 132-135.

<sup>43</sup> Po aty, neni 132.

<sup>44</sup> *Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit*, neni 1, paragrafi 1.

<sup>45</sup> *Ligji Nr. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore*, 28 maj 2015, Prishtinë, Prishtina, Gazeta Zyrtare Nr.16/26 qershor 2015, neni 13.

<sup>46</sup> *Ligji Nr. 05/L-021 mbi Mbrojtjen nga Diskriminimi*, 28 maj 2015, Prishtina, Gazeta Zyrtare Nr. 16/26 qershor 2015, neni 9.

rasteve të diskriminimit, si në bazë të gjinisë ashtu edhe në baza të tjera.

Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.<sup>47</sup> Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.<sup>48</sup>

Avokati i Popullit si institucion i pavarur kushtetues, ka këtë përbërje: Avokati i Popullit si udhëheqës, pesë zëvendës të Avokatit të Popullit, personeli profesional, administrata. Ashtu siç vërehet përveç avokatit të popullit si institucion, në përbërjen e tij ka edhe mekanizmat e tjerë të brendshëm që e ndihmojnë punën e Avokatit të Popullit, përfshirë këtu zëvendësit e tij, që e luajnë rolin kyç, por edhe personeli profesional dhe administrata të cilët ndihmojnë shumë në realizimin e parimeve në të cilat bazohet puna e tij.<sup>49</sup>

## **2.1. Mandati dhe roli i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.**

Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilëve Avokati i Popullit pranon dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i/e cili/a pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga autoritetet publike në Kosovë.<sup>50</sup> Avokati i Popullit është i pavarur në ekzekutimin dhe ushtrimin e kompetencave, rrjedhimisht nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike, të cilat janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, në pajtim me ligjin. Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit,<sup>51</sup> si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e

<sup>47</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 134.

<sup>48</sup> Po aty, neni 133, paragrafi 2.

<sup>49</sup> Arsim Bajrami, "Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2014, fq. 384.

<sup>50</sup> Raporti vjetor - 2020, Prishtinë 2021, fq. 10.

<sup>51</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3, paragrafi 1.

detyrave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligj.<sup>52</sup>

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime apo ndërhyrje nga autoritetet tjera publike, të cilat janë të detyruara t'ju përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, që kërkon administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të administratës publike karshi qytetarëve që ndikon në forcimin dhe zhvillimin e sundimit të ligjit, janë objektivat kryesore të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit vazhdimisht është i angazhuar për ngritjen e besimit të qytetarëve në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe autoritetet e tjera publike. Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdorë ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit. Shërbimet e ofruara nga IAP janë falas.<sup>53</sup> Gjithashtu është në tagrin kushtetues të institucionit të Avokatit të Popullit që në përmbushje të funksioneve të tij të jetë në gjendje ta bëjë administratën publike më të ndjeshme ndaj opinionit publik dhe më të përgjegjshme ndaj kërkesave për drejtësi dhe besueshmëri. Me fjalë të tjera, Avokati i Popullit gëzon të drejtën dhe detyrimin që në bashkëpunim me zyrtarët publikë në nivel qendror apo vendor të përpiqet për krijimin e një kulture demokratike dhe standardeve më të larta të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në vend.<sup>54</sup>

### ***Skema organizative e Institucionit të Avokatit të Popullit.***

---

<sup>52</sup> Po aty, neni 3, paragrafi 3.

<sup>53</sup> *Raporti vjetor - 2019*, Prishtinë 2020, fq. 12.

<sup>54</sup> *Raporti vjetor – Për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit*, 2019.




Figure 1 Raporti vjetor – 2011, Prishtinë, fq. 154.

## 2.2. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të kompetencave të tij, Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, me ligje, me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNj).<sup>55</sup>

Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale, e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, me çështjet e barazisë dhe me mbrojtje nga diskriminimi. Avokati i Popullit nuk ndërhyr në rastet dhe në procedurat e tjera gjyqësore, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave. Por, Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për

<sup>55</sup> Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.

funksionimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.<sup>56</sup> Avokati i Popullit, në kuadër të përgjegjësive si MKPT, është i obliguar që t'i vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrën e emigracionit dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut). Avokati i Popullit bashkëpunon me mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë në aspektin e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, poshtërues dhe jonjerëzor. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe për institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria, pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe të kushteve të tyre.<sup>57</sup>

Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me legjislacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe të barazisë të paraqitura te Avokati i Popullit, të cilat edhe i publikon; nxjerr raporte dhe jep rekomandime për politikën dhe për praktikën për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët socialë dhe me OJQ-të të cilat merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit, si dhe me trupa ndërkombëtarë të ngjashëm me Avokatin e Popullit.<sup>58</sup> Në të njëjtën mënyrë, siç është vënë në pah nga KE, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka krijuar një mungesë të konsistencës duke zgjeruar shtrirjen e mandatit të Avokatit të Popullit edhe tek sektori privat, ndërsa në Kushtetuta e kufizon atë vetëm në sektorin publik.<sup>59</sup>

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me

---

<sup>56</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 113, paragrafi 2, neni 135, paragrafi 4, *Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit*, neni 16, paragrafi 10. *Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës*, neni 29.

<sup>57</sup> *Raporti vjetor - 2020, Prishtinë 2021*, fq. 11.

<sup>58</sup> *Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit*, neni 16, paragrafët 13 dhe 16.

<sup>59</sup> Këshilli i Evropës, Mbështetja ndaj implementimit të reformave dhe standardeve mbi të drejtat evropiane të njeriut për institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë\*, Strasburg, 2017, fq. 9.

rekomandime për institucionin publik, për t'i mënjeluar shkeljet. Raporti i drejtohet autoritetit i cili ka bërë shkelje, kurse kopja e raportit i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe organizatave të tjera përkatëse. Ndërsa raportin vjetor për vitin paraprak, Avokati i Popullit i'a paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 31 mars të vitit vijues, i cili shqyrtohet në seancë plenare në Kuvend gjatë sesionit pranveror.<sup>60</sup>

### **Kapitulli III**

#### **Instutucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

#### **3. Pozita Kushtetuese e Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

Si në shumicën e vendeve, po ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë se Veriut ekziston një organ i veçantë i cili mbron të drejtat civile dhe individuale kushtetuese dhe ligjore kur shkelen me akte, veprime dhe mungesë veprimesh nga organet e administratës shtetërore dhe organizatat e tjera me kompetenca publike, organ i cili ndërmerr veprime dhe masa për mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të duhur dhe të barabartë të komuniteteve në organet shtetërore, lokale organet e departamenteve qeveritare dhe institucionet dhe shërbimet publike, dhe ky organ është Avokati i Popullit.<sup>61</sup>

Avokati i Popullit është organ i Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili i mbron të

---

<sup>60</sup> Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 29.

<sup>61</sup> Jadranka Denkova, "Roli i Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë si kontrollues i punës së administratës shtetërore", 2016, fq. 3.

drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të të gjithë personave tjerë kur ato u shkelen me akte, veprime dhe lëshim të veprimeve nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat tjera që kanë autorizime publike dhe i cili ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësisve të vetëadministrimit lokal dhe të enteve dhe shërbimeve publike.<sup>62</sup> Avokati i Popullit zgjidhet për periudhë kohore prej tetë vitesh, me të drejtë edhe për një zgjedhje. Kushtet për zgjedhjen dhe shkarkimin, kompetencat dhe mënyra e punës së Avokatit të Popullit rregullohen me ligj.<sup>63</sup> Funkcionin e tij Avokati i Popullit e ushtron në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit sipas të cilit shërben si mekanizëm ligjor mbrojtës për mbikëqyrjen, zhvillimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik.

Avokatin e Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut e zgjedh kuvendi me propozim të komisionit kompetent të Kuvendit, e zgjedh dhe shkarkon avokatin e popullit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës duhet patjetër të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Avokati i popullit zgjidhet për kohëzgjatje prej tetë vjetësh me të drejtë edhe të një zgjedhje. Avokati i popullit ka më shumë zëvendës. Numrin e zëvendësve të avokatit të popullit e cakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës patjetër duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Zëvendësit e avokatit të popullit zgjedhen me kohëzgjatje prej tetë vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes. Procedura e zgjedhjes së avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij fillon tre muaj para skadimit të mandatit të tyre. Në rast të mungesës ose pengesës, avokatin e popullit e zëvendëson zëvendësi sipas radhitjes së caktuar nga avokati i

---

<sup>62</sup> *Ligji për Avokatin e Popullit* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2003, 114/2009, 181/2016, 189/2016 dhe 35/2018). Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U. nr. 111/2007 të datës 29 tetor 2008, botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 143/2008, neni 2.

<sup>63</sup> *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, neni 77.



popullit.<sup>64</sup>

### **3.1. Mandati dhe roli i Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

Avokati i Popullit veprimtarinë e vet e zhvillon në kuadër të Kushtetutës dhe të Ligjit, si dhe në kuadër të konventave dhe akteve juridike ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut. Është insitucion i pavarur, i mëvetësishëm dhe profesional, i cili gjatë kryerjes së detyrave udhëhiqet nga parimet e objektivitetit, paanësisë, përgjegjësisë, ndershmërisë, azhuritetit, ekspedivititetit, papërcaktueshmërisë fetare a partiake, barazisë në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare a bindjen fetare ose politike, gjininë, racën etj.<sup>65</sup> Roli i tij është etik dhe moral në drejtim të respektimit dhe ushtrimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Prandaj, veprimet e tij kryesisht kanë për qëllim promovimin dhe përmirësimin e performancës efikase dhe efektive të administratës publike si shërbim ndaj qytetarëve për të ushtruar të drejtën e tyre dhe rolin edukativ dhe këshillues në qasjen dhe komunikimin me qytetarët.<sup>66</sup>

Mbrojtja nga diskriminimi është pjesë thelbësore nga të gjitha të drejtat e njeriut dhe e garanton të drejtën e barazisë për të gjithë. Barazia e lirive dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve është e garantuar me kushtetutë, pavarësisht nga seksi, gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe sociale, bindjet politike dhe religjioze, gjendja pronësore dhe shoqërore etj. Ekzistimi i trupit të pavarur institucional siç është Avokati i Popullit, që do të përgjigjet para pushtetit ligjvënës, përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhurit e popullit – deputetët, dhe padyshim do të qëndrojë në anën e qytetarëve, kur të drejtat e tyre të njeriut janë shkelur nga ana e aparatit shtetëror dhe organeve tjera me autorizime publike, ka rëndësi të madhe për sistemin e përgjithshëm juridik në një shtet dhe për zbatimin praktik të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Avokati i Popullit e ka për obligim t'i mbrojë qytetarët nga diskriminimi, në mënyrë aktive t'i vëzhgojë problemet e tyre juridike lidhur me diskriminimin, të marrë pjesë në

---

<sup>64</sup> *Ligji për Avokatin e Popullit*, neni 5.

<sup>65</sup> Më shumë shih: [http://ombudsman.mk/en/basic\\_questions/671/what\\_is\\_the\\_ombudsman\\_.aspx](http://ombudsman.mk/en/basic_questions/671/what_is_the_ombudsman_.aspx) çasja e fundit më datën 13.09.2021 në ora 12:22.

<sup>66</sup> Më shumë shih: <https://ennhri.org/our-members/north-macedonia/> çasja e fundit më datën 15.09.2021 në ora 1:54.

zgjdhjen e tyre dhe të veprojë në mënyrë adekuate sipas parashtesave për mbrojtje nga diskriminimi, por edhe të avokoj për avancimin e kornizës ligjore për jo diskriminim dhe tejkalimin e mangësive të tij.<sup>67</sup> Avokati i Popullit duhet të vazhdoj me përpjekjet dhe aktivitetet e tij në luftën kundër diskriminimit në kuadër të mandatit të tij. Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi duhet ta fuqizojnë qasjen deri te drejtësia për viktimat e diskriminimit, në atë mënyrë që do t'i çlirojnë nga shpenzimet gjyqësore për hapjen e procedurave gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi; fuqizimi i pavarësisë së Komisionit për Parandalimin e Diskriminimit; dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për diskriminim.<sup>68</sup> Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me institucionet, Avokati i Popullit konstaton pengim të ashpër nga një numër më i madh i institucioneve, siç është Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria Publike, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe NP “Ujësjetllës dhe kanalizime.”<sup>69</sup> Ai madje ka qenë edhe i penguar që të flasë para deputetëve në parlament edhe pse me shqyrtimin e buxhetit të vitit 2015 të Avokatit të Popullit shkurtoheshin rreth 4.23 milionë denarë.<sup>70</sup>

### **3.2. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

Kompetencat e autoriteteve publike në Maqedoni përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligje, rregullore, akte nënligjore dhe rregulla të veçanta. Funkcionimi i tyre është themeluar ligjërisht përmes Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Ligjit për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe normave të ndara ligjore për institucionet e

---

<sup>67</sup> Rezime përfundimtare: *Raportimi i monitorimit të punës së Avokatit të Popullit me fokus të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi* – 2010-2019.

<sup>68</sup> Mes veprimit dhe mosveprimit – *Reformat ne kapitullin e 23, i hartuar nga Instituti për Politikë Evropiane* – Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

<sup>69</sup> Raporti vjetor për nivelin e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>.

<sup>70</sup> Më shumë shih: <https://klankosova.tv/maqedoni-avokatit-te-popullit-nuk-i-lejohet-te-flase-ne-kuvend/> çasja e fundit më datën 15.09.2021 në ora 20:32.

tjera publike.<sup>71</sup>

Avokati i popullit në kryerjen e detyrave nga kompetenca e tij ndërmerr masa dhe veprime për të cilat është i autorizuar me këtë ligj për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve ose mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive kur ato u janë shkelur nga organet nga neni 2 i këtij ligji.<sup>72</sup> Avokati i popullit ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen nga zvarritja e pa arsyeshme e proceseve gjyqësore ose të kryerjes së punëve të shërbimeve gjyqësore me papërgjegjësi dhe pa ndërgjegje, duke mos i cënuar principet e mëvetësisë dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Avokati i popullit nuk vepron për lëndë për të cilat procesi gjyqësor është në vijim, përveç rasteve nga paragrafi 1 i këtij neni.<sup>73</sup> Kompetencat e Avokatit të Popullit nuk zbatohen për sektorin privat ose gjyqësorin, përveç rasteve të vonesave të pajustificuara në procedurat gjyqësore ose të papërgjegjshme të shërbimeve gjyqësore. Në atë kuptim, Avokati i Popullit nuk ka kompetenca legjislative, ekzekutive apo gjyqësore, dhe nuk është as organ ndjekës dhe as autoritet inspektues.<sup>74</sup>

Në procedurë para Avokatit të popullit gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në procedurë që mbahet para Avokatit të popullit gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj, gjithashtu është gjuhë zyrtare. Dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative që kanë të bëjnë për përdorimin e gjuhëve në mënyrë adekuate aplikohen edhe në procedurën para Avokatit të popullit.<sup>75</sup> Avokati i popullit, në kuadër të kompetencës së tij e përcjell gjendjen lidhur me garantimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive dhe kryerjen e vizitave dhe shikimeve në organet nga neni 2 i këtij ligji.

Kur Avokati i popullit do të konstatojë se janë cënuar liritë dhe të drejtat kushtetuese të

---

<sup>71</sup> Vlerësimi i bazuar në Listat kontrolluese të Sundimit të Ligjit të hartuara nga Këshilli i Evropës (Komisioni i Venecias), më shumë shih:

<http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2018/12/The-Rule-of-Law-in-Macedonia.pdf>, çasja e fundit më datën 16.09.2021 në ora 19:29.

<sup>72</sup> *Ligji për Avokatin e Popullit*, neni, 11.

<sup>73</sup> Po aty, neni 12.

<sup>74</sup> Më shumë shih: <https://ennhri.org/our-members/north-macedonia/> çasja e fundit më datën 16.09.2021 në ora 20:32.

<sup>75</sup> Po aty, neni 14.

paraqitësit të parashtrësës, nga organet e administratës shtetërore dhe nga organe dhe organizata të tjera që kanë autorizime publike, ose se është cënuar parimi i mosdiskriminimit dhe përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësisë në organet e pushtetit, organet e njësisive të vetadministrimit lokal dhe enteve dhe shërbimeve publike ose nëse janë bërë parregullshmëri tjera dhe nëse vlerëson se ekzekutimi i aktit administrative do të prodhojë dëm të pakompenzueshëm për të drejtën e personit të interesuar, do të kërkojë:

Shtyrje të përkohshme të ekzekutimit të aktit administrativ deri në vendimin e shkallës së dytë dhe

Shtyrje të përkohshme të ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit nga gjykata kompetente.

Sipas kompetencave ligjore, vëllimi i punës dhe sistematizimi i vazhdueshëm i vendeve të punës, zyra e Avokatit të Popullit duhet të ketë më së paku 94 persona të punësuar që në mënyrë efikase dhe efektive të mund të funksionoj dhe t'i mbroj të drejtat e qytetarëve, ndërsa gjendja reale dëshmon se ekipimi kuadrovik i institucionit është nën nivelin e nevojshëm dhe ka vetëm 68% të kapaciteteve të parashikuara (64 të punësuar).<sup>76</sup>

### **3.3 Përvoja praktike e zyrës së Avokatit të Popullit-Specificat dhe realitete të studimeve të rasteve praktike.**

Më 15 dhe 16 korrik 2019, Mekanizmi Parandalues Nacional ka realizuar një vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Drejtorinë e Policisë në Tetovë dhe IEVP-në Burgun e Ohrit. Vizita u realizua në kuadër të kompetencave dhe mandatit që rrjedhin nga Protokollin Fakultativ i

---

<sup>76</sup> “Raporti në hije për kapitullin 23”, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Politik Evropiane, Shkup, fq. 50.

Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional vizitën në Burgun e Ohrit dhe DPD-në e Tetovës e realizoi në disa hapa, në përputhje me Rregulloren dhe Metodologjinë për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese. Ekipi i MKPT-së ka hasur në bashkëpunim të mirë nga zyrtarët e punësuar në IEVP-në Ohër/VPD Tetovë, të cilët kanë ofruar qasje të papenguar në të gjitha objektet dhe instalimet dhe njohuri në dokumentacionin e kërkuar. Institucioni ka kapacitet për 35 fëmijë, ndërsa në momentin e vizitës në VPD Tetovë kanë qenë 14 fëmijë, të gjithë meshkuj, prej të cilëve 10 në vendngjarje, 2 fëmijë në arrati, ndërsa 2 të tjerët janë transferuar në Burg për të mitur për krim. Burgu për të mitur numëronte 10 persona, të gjithë meshkuj.

Gjatë vizitës në Burg, ekipi i MKPT-së pati mundësinë të vizitojë dhe inspektojë pavijonet dhe ambientet/pjesë shtesë të këtij institucioni: Ambientet në të cilat janë duke u shërbyer të miturit e dënuar; Ambientet e DPD-së në të cilat akomodohen fëmijët për të vuajtur dënimin masë edukative korrektuese; Dhomat e izolimit / izolimi; Njësia e Paraburgimit; Kuzhina dhe dhoma e ngrënies; Lavanderi; Salla e ekzaminimit; Klasë / Sallë TV; Raftë; Sallë për ushtrime – palestër; Dhoma e ligjit.

IEVP-Burgu Ohër nuk ka dhoma të veçanta për izolim, kështu që ambientet e vetmisë shfrytëzohen si izolim, si dhe nuk posedon dhomë për kryerjen e bastisjes së personave të dënuar/të paraburgosur pas pranimit në Institucion. Kontrollat e të dënuarve bëhen në korridorin ndërmjet dy dyerve përballë hyrjes së burgut dhe të të paraburgosurve në dhomën e bisedës me avokatin.<sup>77</sup>

Në Institucion nuk ka staf mjekësor të punësuar, përkatësisht punonjës shëndetësor/infermier. Mjeku vjen nga Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe kujdeset vazhdimisht për kujdesin shëndetësor të fëmijëve të Institucionit Korrektues dhe të Burgut të të Miturve. Në këtë mënyrë shmanget praktika e mëparshme e ndryshueshme e ekipit mjekësor,

---

<sup>77</sup> Raport special për një vizitë të rregullt të paparalajmëruar në VPD Tetovë dhe IEVP Ohër. Më shumë shih: [Poseben izvestaj -VPD Tetovo i Zatvor Ohrid.pdf](#).

varësisht se cili mjek është në detyrë. Kjo situatë zgjat më shumë se një vit dhe ka rezultuar se është shumë më e përshtatshme për fëmijët, sepse i njëjti mjek monitoron gjithmonë shëndetin e tyre. Gjatë inspektimit të ambulancës, ekipi i MKPT-së konstatoi se dhoma është e ndriçuar me dritë artificiale, nuk ka dritare apo dritë dite, higjiena në ambulancë është në nivel të kënaqshëm, por është e pajisur minimalisht, me pajisjet e nevojshme (tavolina e mjekut, shtrati i ekzaminimit mjekësor dhe dy kabinete mjekësore). Shqetësues është edhe fakti se kushtet për privatësi gjatë ekzaminimit mjekësor të një fëmije në ambulancë janë pothuajse inekzistente.

Nga inspektimi i Institucionit, si dhe nga bisedat me personat përgjegjës, ekipi i MKPT-së konstaton se kujdesi shëndetësor i fëmijëve ofrohet përmes Shtëpisë Shëndetësore Ohër, ku një herë në javë vjen një mjek i cili kontrollon fëmijët që kanë nevojë për mjekim, ekzaminim dhe nëse është e nevojshme vjen shtesë ose në thirrje. Gjatë bisedës me Zëvendësdrejtorin, ekipi i MKPT-së u njoftua se shpenzimet për shërbimet shëndetësore, gjegjësisht kujdesin shëndetësor të fëmijëve i përballon Institucioni. Sipas bisedave me personin mjekësor përgjegjës, çdo fëmijë i sapoprانuar kontrollohet nga mjeku në 24 orët e para pas pranimit në Institucion<sup>78</sup>. Megjithatë, duke pasur parasysh bisedat me fëmijët e akomoduar në Institucion, si dhe këqyrjen e dokumentacionit mjekësor, ekipi i MKPT-së konstatoi se fëmijët e sapo pranuar nuk kontrollohen gjithmonë nga mjeku në 24 orët e para të pranimit në Institucion, i cili është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së Shtëpisë për të mbrojturit që i nënshtrohen masës edukative - referim në institucionin korrektues, si dhe në kundërshtim me Rregulloren e Shtëpisë për personat e dënuar që vuajnë dënimin me burg në I EVP. Gjegjësisht, ka pasur raste të fëmijëve që janë në paraburgim dhe të cilët nuk janë ekzaminuar në ditën e pranimit, por ekzaminimi kryhet në ditën kur mjeku vjen rregullisht në Institucion.

Nga këqyrja e dosjeve, ekipi i MKPT-së arriti në përfundimin se në pjesën më të madhe të dosjeve të fëmijëve të akomoduar në Institucion është evidentuar se janë fëmijë me “çrregullim të sjelljes, sjellje antisociale, çrregullim personaliteti, me prag të ulët tolerimi ndaj frustrimit, impulsivitet dhe sjellje agresive, e ndjekur nga sjelljet devijuese, si dhe statusi i ulët social dhe arsimor.” Çrregullime të tilla shpesh janë rezultat i neglizhencës afatgjate, abuzimit

---

<sup>78</sup> Neni 12 paragrafi 1 i Rregullores së Shtëpisë për të mbrojturit në vuajtje të masës edukative - referim në institucionin korrektues dhe neni 10 paragrafi 1 i Rregullores së shtëpisë për personat e dënuar që vuajnë dënimin me burg në institucionin ndëshkimor-korrektues.

fizik dhe emocional në familjet e tyre kryesore, por edhe në institucionet në të cilat ata ishin strehuar më parë.

Nga këqyrja e evidencës për dënimet e shqiptuara disiplinore, është konstatuar se në vitin 2019 janë shqiptuar gjithsej 8 dënime disiplinore, nga të cilat: 5 dënime disiplinore - izolim 10 ditë, 2 dënime disiplinore - izolim 5 ditë dhe një shtyrje me kusht të dënimit disiplinor të izolimit për 5 ditë. Nga regjistri i dënimeve disiplinore mund të konstatohet se fëmijët që janë dërguar në vuajtje të dënimit disiplinor në izolim janë disiplinuar disa herë më parë.

Nëse marrim parasysh standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KRT) të cilat përcaktojnë se izolimi duhet të vendoset vetëm për një periudhë të shkurtër dhe në asnjë rrethanë më shumë se 3 ditë, padiskutim rezulton se vendosja dhe ekzekutimi i sanksioneve disiplinore për një periudhë prej 5 deri 10 ditësh për fëmijët që vuajnë dënimin me burgim për të mitur është në kundërshtim me standardet e përcaktuara.<sup>79</sup>

Ekipi i MKPT rekomandon gjithashtu që në të ardhmen, me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore dhe shqiptimit të sanksioneve disiplinore, vëmendje e veçantë t'i kushtohet dispozitave të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve, të cilat përcaktojnë se “Nuk lejohet masë e posaçme mbajtje për fëmijët e rendit dhe disiplinës - izolim”.<sup>80</sup>

Në të njëjtin drejtim është edhe rekomandimi që përmban Deklarata e Stambollit për përdorimin dhe efektet e izolimit<sup>81</sup>, i cili përcakton se izolimi duhet të ndalohej absolutisht në rastin e fëmijëve nën 18 vjeç. Nga intervistat me të miturit e paraburgosur, ekipi i MKPT mori informacione se ndaj tyre shpesh përdorej forcë nga pjesëtarët e policisë së burgjeve. Ekipi i MKPT shpreh shqetësim serioz për gjendjen aktuale në institucione, për faktin se mungon një ekip shumëprofesional (punonjës social, pedagog dhe terapist profesional) që do të kontribonte në realizimin me sukses të procesit të risocializimit të fëmijëve.

Ekipi i MKPT-së, në një bisedë me dy punëtorët-educatorë profesionistë, ka marrë informacion se në I EVP ndodhen gjithsej 10 fëmijë të moshës 16 deri në 23 vjeç. Ekziston një

---

<sup>79</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT), “*Të miturve të privuar nga liria sipas ligjit penal*” - (CPT / Inf (2015) 1 pjesë rev1) 3 Neni 305 i *Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve* (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 99/2019).

<sup>80</sup> Neni 305 i *Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve* (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 99/2019)

<sup>81</sup> Miratuar më 9 dhjetor 2007 në Stamboll në Simpoziumin Ndërkombëtar për Traumën Psikologjike.

strukturë heterogjene e fëmijëve sipas: llojit të krimit, statusit social-ekonomik, përkatësisë etnike, vendndodhjes gjeografike dhe periudhës kohore të vuajtjes së dënimit.

Ekipi i MKPT-së mirëpret faktin që profesionisti informon fëmijët dhe familjet e tyre për të drejtat e tyre ligjore, për ndihmën dhe mbështetjen që u vjen në periudhën e ndëshkimit dhe atë pas ndëshkimit. Përkatësisht, fëmijët dhe familjet kanë takime dhe kontakte të rregullta me edukatoren profesionale. Frekuenca e takimeve varet nga nevojat, problemet dhe interesat e tyre aktuale. Institucioni ka një dhomë të veçantë për takimet e fëmijëve me anëtarët e familjeve të tyre. Në këtë drejtim, ekipi i MKPT-së konstatoi se fëmijët nuk janë të njohur plotësisht me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të tyre, as me mundësinë se ku dhe si mund të adresojnë ankesat lidhur me trajtimin e tyre dhe shkeljen e mundshme të të drejtave të tyre. Prandaj, ekipi i MKPT rekomandon që autoritetet e burgjeve të marrin masa të menjëhershme për të informuar fëmijët, në mënyrë të përshtatshme për moshën, se si dhe ku të adresojnë ankesat në rastet kur ata mendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur. Në këtë drejtim, ekipi i MKPT rekomandon mbajtjen e këshillimeve tematike me fëmijët, si dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve informative në formën e një liste informacioni mbi sistemet e ankesave në dispozicion të tyre, si nga brenda për autoritetet e burgjeve ashtu edhe nga jashtë - ankesë tek Avokati i Popullit dhe tek organet ndërkombëtare. Fëmijët duhet të njihen me mënyrën, gjegjësisht procedurat sipas të cilave do të veprohet për ankesat e tyre nga organet kompetente.

Për sa i përket higjienës, ekipi i MKPT-së konstaton se për higjienën e ambienteve kujdesen vet fëmijët. Dhe gjatë vizitës ambientet ishin përgjithësisht të pastra. Dhomat kanë shtretër, dollapë për ruajtjen e sendeve personale, TV dhe dritare të mëdha nga të cilat hyn mjaftueshëm dritë dite. Shtretërit janë të pastër dhe të rregullt.

Në bazë të situatës së konstatuar dhe konstatimeve nga vizita e realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional ka përgatitur një Raport të Veçantë në të cilin ka konstatuar gjendjen dhe ka dhënë rekomandime përkatëse drejtuar Drejtorisë për Ekzekutim të Sanksioneve dhe Drejtorit të Burgut të Ohrit, me qëllim eliminimin e mangësive dhe rreziqeve.<sup>82</sup>

---

<sup>82</sup> Raport special për një vizitë të rregullt të paparalajmëruar në VPD Tetovë dhe IEVP Ohër. Më shumë shih: [Poseben izvestaj -VPD Tetovo i Zatvor Ohrid.pdf](#).



## KAPITULLI IV

### **Gjendja e të Drejtave të Njeriut dhe përdorimi i gjuhëve nga komunitet-bashkësitë jo shumicë, - në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

#### **4. Të drejtat e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.**

Edhe pse Kosova nuk mund të bëhet zyrtarisht palë në konventat dhe mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, neni 22 i Kushtetutës përcakton që tetë instrumente të të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KB)<sup>83</sup> dhe rajonale<sup>84</sup> zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, duke ofruar kështu burime plotësuese ligjore që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në kapitullin e tretë të saj ka paraparë një sistem të veçantë të pozitës së komuniteteve, këto grupe etnike, fetare dhe kulturore (pakicë), në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, njihen si komunitete.<sup>85</sup> Akti në të cilin paraqiten shtyllat e mbrojtjes së pakicave kombëtare është “Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” e miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1995. Ky dokument instalon standardet themelore në kuadër të kornizës ligjore për mbrojtjen e pakicave kombëtare, mbrojtja e pakicave kombëtare dhe lirive të personave që i përkasin këtyre pakicave është pjesë përbërëse e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe si e tillë bën pjesë në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.<sup>86</sup>

---

<sup>83</sup> Domethënë, [Universal Declaration of Human Rights | United Nations](#) (10 dhjetor 1948) (në tekstin e mëtejme DUDNJ); [OHCHR | International Covenant on Civil and Political Rights](#) (16 dhjetor 1966) 999 UNTS 171 (në tekstin e mëtejme PNDGP); [OHCHR | International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination](#) (4 janar 1969) 660 UNTS 195 (në tekstin e mëtejme KEGFDR); [OHCHR | Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women](#) (3 shtator 1981) 1249 UNTS 13 (në tekstin e mëtejme KEGFDG); [OHCHR | Convention on the Rights of the Child](#) (2 shtator 1990) 1577 UNTS 3 (në tekstin e mëtejme KDF); dhe [OHCHR | Convention against Torture](#) (26 qershor 1987) 1465 UNTS 85 (në tekstin e mëtejme CAT).

<sup>84</sup> Në mënyrë specifike, *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore* (4 nëntor 1950) 213 UNTS 221 (në tekstin e mëtejme KEDNJ); the Council of Europe, *Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare* (1 shkurt 1995) ETS 157 (në tekstin e mëtejme FCPNM); *Konventa e KE për Parandalimin dhe Duftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje* (11 maj 2011) CETS 210 (në tekstin e mëtejme Konventa e Stambollit).

<sup>85</sup> Arsim Bajrami, “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2014, fq. 223.

<sup>86</sup> “Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, miratuar nga Këshilli i Evropës, Strasburg, 1995, neni 1.

Konventa në fjalë trajton mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe garanton të drejtat elementare në kuadër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Për të pasur një pasqyrë më të qartë, në këtë drejtim do të tërheqim një paralele me rastin dhe pozitën e pakicave kombëtare në Kosovë. Fillimisht është e udhës të përmenden të drejtat elementare të cilat i promovon konventa, duke filluar nga e drejta për jetë, e drejta për identitet, liria e tubimit, liria e shprehjes, liria për ushtrimin e lirë të fesë, e drejta për përdorimin e gjuhës, e drejta për arsimim të lirshëm në gjuhën përkatëse, e drejta për mbajtjen e kontakteve me shtetin amë etj.<sup>87</sup> Pra, në sferën e të drejtave të njeriut e sidomos mbrojtjes së të drejtave të pakicave, Republika e Kosovës ka demonstruar përkushtim të veçantë sepse shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare e konsideron si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që i'u përkasin komuniteteve. Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Republika e Kosovës promovon frymën e paqes, tolerancës, dialogut ndër-kulturor dhe ndër-fetar dhe mbështet pajtimin mes komuniteteve.<sup>88</sup>

Baza e pozitës së volitshme kushtetuese e komuniteteve në Republikën e Kosovës është Pakoja e Ahtisarit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 57, ka sendërtuar disa parime të përgjithshme të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Statusi special i komuniteteve dhe pozita e tyre e veçantë, përfshirë të drejtat e tyre vërehet qysh në paragrafin e parë të këtij neni, në të cilin thuhet decidivisht se: *komunitetet gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me kushtetutë, krahas lirive dhe të drejtave të njeriut që Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka paraparë në kapitullin e dytë*. Krahas kësaj është me rëndësi edhe fakti që këto komunitete definohehen si “grup kombëtarë ose etni gjuhësorë ose fetare, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës”. Të njëjtin përkufizim të komuniteteve e bën edhe Pakoja e Ahtisarit dhe Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve në Republikën e Kosovës.<sup>89</sup>

Shumica e parimeve në lidhje me barazinë dhe të drejtat e njeriut të BE-së janë transferuar drejtpërsëdrejti edhe në legjislacionin e Kosovës. Kosova i ka përvetësuar në

<sup>87</sup> Po aty, nenet, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 17.

<sup>88</sup> <https://www.rks-gov.net/AL/f318/liria-qytetare/komunitetet>.

<sup>89</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 57, paragrafi 1, Pakoja e Ahtisarit, aneksi II, neni 1.1 dhe *Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre* në Republikën e Kosovës, neni 1.4.

kushtetutën e saj konventat e të drejtave të njeriut, duke i vendosur ato mbi legjislacionin e brendshëm dhe duke i bërë ato drejtpërdrejtë të zbatueshme nga gjykatat dhe administratat publike. Përveç kësaj janë hartuar dhe miratuar edhe një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore për të mbrojtur dhe promovuar standardet e të Drejtave të Njeriut, duke mbuluar rastet e diskriminimit dhe barazisë gjinore, si dhe forcimin e organeve të së Drejtave të Njeriut dhe mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës.<sup>90</sup> Kushtetuta e Kosovës huazon nga traditat e përbashkëta kushtetuese evropiane me qëllim të projektimit të një kornize të së Drejtave Themelore të bazuara në Sistemin Evropian mbi të Drejtat e Njeriut, në veçanti me qëllim të njohjes së një sërë të drejtave kolektive ndaj minoriteteve.<sup>91</sup> Sa i përket të drejtave individuale, Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës ofron 35 nene të cilat i përkushtohen të drejtave themelore të njeriut, duke filluar nga të drejtat mbi jetën dhe integritetin, deri tek privatësia dhe familja. Sipas Kapitullit III, të drejtat e përbashkëta të komuniteteve përfshijnë respektin e plotë ndaj gjuhës dhe zakoneve të tyre, si dhe përfaqësimi i tyre pranë institucioneve politike dhe administrative. Më tej Neni 22 ofron një numër të mekanizmave të cilat bëhen të aplikueshme në mënyrë automatike, përfshirë këtu edhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, pa marrë parasysh statusin e Kosovës si nënshkruese e saj.<sup>92</sup> Pra me një fjalë njëra ndër karakteristikat e pozitës së komuniteteve në Republikën e Kosovës është arsyeja kryesore që pozita e komuniteteve trajtohet si “*sui generis*”.

Ligjet të cilat përbëjnë të ashtuquajturën Pako të së Drejtave të Njeriut, Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për Barazinë Ligjore dhe Ligji mbi Avokatin e Popullit, janë vetëm një pjesë e sistemit të gjerë qeverisës së Kosovës, i cili është përfundimisht përgjegjës për respektimin e të Drejtave Themelore të Njeriut.<sup>93</sup>

---

<sup>90</sup> Më shumë shih: [Gjendja e te drejtave te njeriut ne kosove.pdf](#) çasja e fundit më datën 16.09.2021 në ora 20:45.

<sup>91</sup> *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.*

<sup>92</sup> *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.*

<sup>93</sup> Më shumë shih: [Gjendja e te drejtave te njeriut ne kosove.pdf](#) çasja e fundit më datën 16.09.2021 në ora 20:51.

#### **4.1. Përdorimi i gjuhës nga ana e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.**

Gjuha e paraqet një tipar bazë të vërtetimit dhe identifikimit të një komuniteti të caktuar dhe përdorimi i lirshëm i saj është një e drejtë elementare që mund t'i garantohet një komuniteti, ndërsa përmasat e garantimit të saj janë në kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku vështuar në aspektin krahasimor me sistemet tjera kushtetuese, garantimin dhe respektimin e kësaj të drejte e ka në nivelin e duhur.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve (**Ligji Nr. 02/L-37**), ku në bazë të kreut 5.4 (a), 5.7, 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001, dhe me qëllim të respektimit të identitetit gjuhësor të të gjithë personave dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi për të gjitha komunitetet që të shprehin dhe të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor, duke u bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe në Protokollin e saj, Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, dhe duke pasur parasysh Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare dhe Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, Udhëzimet mbi përdorimin e gjuhëve minoritare në mediat transmetuese, si dhe me qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve” ka miratuar Ligjin në fjalë. Ligj, i cili duhet të modifikohet dhe të respektohet nga gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 1 të këtij ligji gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës. Gjithashtu sipas nenit 2.3 Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësisht kësaj që u tha më lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare. Poashtu sipas nenit 2.4 të po këtij ligji në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe e cila përfaqëson më shumë se tre (3) përqind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e

asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë dhe do të jetë në përdorim të barabartë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Përveç kësaj, një bashkësi, gjuha e së cilës me traditë është folur në një komunë, do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Lidhur me këtë çështje, komunat do të miratojnë rregullore të hollësishme brenda 6 muajve pas hyrjes së këtij ligji në fuqi, në pajtim me nenin 35 të këtij ligji.

94

Një karakteristikë tjetër e veçantë e cila haset në paragrafin 10 të nenit 8 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre është se nuk përcaktohet në mënyrë vendimtare se mësimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm për komunitetet që zhvillojnë mësim në ndonjërin nga gjuhët që nuk është gjuhë zyrtare, por u lë mundësin që të zgjedhin njërin nga gjuhët zyrtare që d.m.th gjuhën shqipe apo serbe (në shkollat fillore dhe të mesme në të cilat gjuha e mësimi nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit do të mësojnë një gjuhë zyrtare sipas zgjedhjes së tyre në pajtim me ligjin)<sup>95</sup>.

Në vitin 2007, Qeveria e Kosovës, e ka krijuar edhe Komisionin për Gjuhët si organ i krijuar në pajtim me nenin 32 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji, ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes të gjuhëve zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në Kosovë si dhe për të siguruar, mbrojtur gjuhët e komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare.<sup>96</sup> Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ofron dhe siguron qasjen e barabartë në drejtësi, për qytetarët e Republikës së Kosovës, duke konfirmuar gatishmërinë e institucioneve të Kosovës në promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e parimeve të të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Për të siguruar respektimin e të drejtave themelore, Agjencia ofron ndihmë juridike në gjuhën e palës.<sup>97</sup>

Gjithashtu edhe sipas Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës<sup>98</sup> garantohet barazi e plotë dhe efektive për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve dhe është në harmoni me Konventën Kornizë e Këshillit

---

<sup>94</sup> Ligji Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve, neni, 1.

<sup>95</sup> *Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës*, Nr. 03/L-047, Neni 8, paragrafi 10.

<sup>96</sup> [Zyra e Komisionerit për Gjuhë - Zyra e Kryeministrit të Kosovës \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net).

<sup>97</sup> *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2017-2021*, fq. 267.

<sup>98</sup> *Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës*.

Evropian për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Në bazë të këtij ligji të gjithë personat që i përkasin komuniteteve kanë të drejtë ti gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që janë të përcaktuara me obligimet ligjore ndërkombëtare.

#### 4.2. Të drejtat e etniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Maqedonia është një realitet historik, politik, ekonomik dhe kulturor, një pjesë shumë e rëndësishme e Ballkanit, e cila është e njohur me diversitetin e vet etnik dhe kulturor. Disa, këtë hapësirë jetike e kanë cilësuar epiqendra ose zemra e Ballkanit.<sup>99</sup> Mozaiku kulturor i quajtur Maqedoni, që veçohet me një “diversitet të thellë” (Taylor, 1994), është një gjendje natyrore. Nëse i shikojmë të dhënat statistikore, do të vërejmë se në të gravitojnë përkatësi të ndryshme etnike e fetare, të cilët krijojnë një shumëngjyrshmëri. Shikuar nga prizmi fetar, shumica e popullatës është ortodokse, por ka edhe zëra që flasin se gjysma e popullatës është e përkatësisë islamike (BFI).<sup>100</sup> Se udhëheqësit e Maqedonisë, që në zanafillë po mbillnin farën e një konflikti etnik, kjo dukej që me sjelljen e aktit të parë politik – Deklarata për Pavarësinë e Maqedonisë.<sup>101</sup> Që në nenin 1 të kësaj deklaratë shihej qartë synimi për krijimin e një shteti një nacional që nuk respektonte përbërjen e popullsisë që jetonte në Maqedoni.<sup>102</sup> Ky formulim<sup>103</sup> në mënyrë shumë të qartë përcakton karakterin e shtetit të ri si shtet nacional maqedonas, duke përjashtuar mundësinë e themelimit të një shteti multietnik, ku të përfshiheshin shqiptarët dhe popujt tjerë që jetonin në Maqedoni.<sup>104</sup>

Mbajtja e një referendumi i cili do ta legjitimonte krijimin e një shteti një nacional në një shoqëri multinacionale, do të jetë edhe një faktor i cili do të rrisë pakënaqësinë e popullit

---

<sup>99</sup> Ahmet Davutogllu, ligjëratë e mbajtur në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodi” me rastin e dhënies së çmimit Doctor Honoris Causa, 25 mars 2010.

<sup>100</sup> Prof. Dr. Ali Pajaziti, *Demokracia iliberale dhe etatizmi kulturor kundër GEIST-it multiculturalist*.

<sup>101</sup> “Deklaratë për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë”, Flaka e vëllazërimit, Shkup: 27 janar 1991.

<sup>102</sup> Sipas CIA, *The World Factbook*, <https://www.cia.gov/library/publications/the-worldfactbook/geos/mk.html> dhe të dhënave nga regjistrimi i fundit në Maqedoni (2002) përbërja etnike e Maqedonisë është si vijon: maqedonas 64.2%, shqiptarë 25.2%, turq 3.9%, romë 2.7%, serbë 1.8%, të tjerë 2.2%. Megjithatë numri i popullatës shqiptare përfaqëson 1/3 e popullsisë që jeton në Maqedoni. Rahim Veliu: "Geographical span and the Albanian population movement in Macedonia" Tetovë, 2002, f.40

<sup>103</sup> Neni 1 i Deklaratës ku thuhej se ideja e krijimit të Maqedonisë së pavarur shprehte të drejtën e popullit maqedonas për vetëpërcaktim. “Deklaratë për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë”, op. cit.

<sup>104</sup> Zeqirja Rexhepi, “*Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990-2001*”, Tetovë: 2005, f. 32

shqiptar në Maqedoni dhe do ta thellojë edhe më shumë konfliktin ndëretnik.

Referendumi u mbajt megjithëse shqiptarët e bojkotuan atë. Në të njëjtën mënyrë, pa pjesëmarrjen e shqiptarëve, kushtetuta u miratua me gjithë formulimet që shqiptarët i trajtonin si qytetarë të rendit të dytë e jo si popull shtetformues.<sup>105</sup>

Parimet kushtetuese të Maqedonisë së pavarur ishin trashëguar nga kushtetuta jugosllave e vitit 1974, e cila vendosi një sistem tre nivelesh për republikat e saj: kombet, kombësitë dhe kombësitë e tjera dhe grupet etnike, të cilët do ta quanin veten jugosllavë.<sup>106</sup> Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1991 krijonte kështu në mënyrë të ngjashme një sistem identifikimi dy nivelesh të përbërë nga populli kryesor dhe minoritetet.

Vetë preambula e kësaj kushtetute dëshmonte tendencat për krijimin e formës së shtetit-komb në vend të shtetit qytetar, ku të gjithë etnikumet do të ndjeheshin të barabartë.<sup>107</sup> Shteti mbështetet kështu mbi popullin kryesor, i cili sipas këtij parimi karakteristik, do të ketë legjitimitet superior mbi atë të minoriteteve.<sup>108</sup>

Gjithnjë duke pasur parasysh faktin se shqiptarët përbëjnë një të tretën e numrit të popullsisë në këtë shtet dhe ata janë banorë autoktonë në këto troje, inkuadrimi i këtij sistemi nivelizues, ku shqiptarët barazoheshin me minoritetet e tjera, do të rrisë mllëfin e tyre. Ndërkaq edhe vetë Maqedonia do të kategorizohet si shtet me nacionalizëm kushtetues, ndonëse de facto me cilësi të një shoqërie tipike multietnike.<sup>109</sup>

Marrëveshja e Ohrit është një dokument i cili vendosi parimet bazë të një shteti qytetar. Përkundër pretendimeve të konstitucionalistëve maqedonas se intervenimet në preambulën e kushtetutës janë bërë në shpirtin e konstitucionalizmit evropian dhe shkëputjes radikale nga

---

<sup>105</sup> Sipas Sërgjan Kerim-it ndër pesë hendikepet e demokracisë maqedonase dhe arsyt pse Maqedonia në vitin 2001 ra në darën e krizës të parin vë “miratimi i kushtetutes pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të etnikumit të dytë më të madh të shtetit”. Srgjan Kerim, “Urat e së ardhmes”, Tiranë: Ideart, 2006, f.164-165

<sup>106</sup> Mr. Wm. Hamilton, “*Commentary No. 16: Yugoslavia: Nations, Nationalities and Other Nationalities*”, dhjetor 1991, <http://www.csis-scrs.gc.ca/pblctns/cmmntr/cm16-eng.asp>

<sup>107</sup> Në preambulë thuhet se “... Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohen të drejtat e barabarta qytetare dhe për bashkëjetesë të përhershme të popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe nacionalitetet e tjera të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë”, Sluzben Vesnik na RM, nr.52, 22 nentor, 1991, f. 13. Në Joseph Marko, “The Referendum for Decentralization in Macedonia in 2004: A Litmus Test for Macedonia’s Interethnic Relations, European Yearbooks of Minority Issues Vol 4, 2004/2005, f. 9 thuhet “Politikanët sllavomaqedonas shmangën negociatat komplekse, pakte dhe marrëveshje konsensuale në këtë periudhë”.

<sup>108</sup> Natacha Andonovski, “*Les Albanais de Macédoine: perspectives et limites d’une double identité*” në Christophe Chiclet et Bernard Lory (ed.) “La République de Macédoine”, Paris, 1998, f.66

<sup>109</sup> [Marrëveshja Ohrit.pdf](#), fq. 93.

koncepti tradicional i shtetit komb, “ndryshimet në Kushtetutë ishin më shumë në nivel të terminologjisë se sa parimeve”.<sup>110</sup> Në preambulë, në vend që të thuhet “nacionaliteti shqiptar”, tani thuhet “pjesë e popullit shqiptar”. Gjithkund tjetër nacionaliteteve u referohet me term neutral “komunitetet”<sup>111</sup> ose “qytetarë në njësitë administrative ku së paku 20% e tyre flasin gjuhë tjetër nga ajo maqedonase”<sup>112</sup>. Sistemi dy nivelesh “populli maqedonas” dhe “pjesët e popujve”, si dhe vënia në një vijë e shqiptarëve me komunitetet tjera jo maqedonase, akoma mbajnë recidiva të kushtetutës jugosllave të 1974.

Përveç parimeve bazë kjo marrëveshje përfshin: përfaqësimin e qeverisjes së decentralizuar, parimin e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë, procedurat e veçanta parlamentare që përfshijnë “*shumicën e Badinterit*”, arsimi dhe përdorimi i gjuhëve, shprehja e identitetit, pjesën e implementimit dhe shtojcat me amendamentet kushtetuese, ndryshimet ligjore dhe masat e krijimit të besimit. Parime këto, megjithëse ideale për një shtet si Maqedonia, mbeten të pazbatuara edhe pas një dekade.<sup>113</sup> Kjo demokraci eviton përjashtimin dhe diskriminimin në çfarëdo baze. Marrëveshja e Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese zyrtarizuan një gjë të tillë, duke inkuadruar parimet e lartpërmendura, por edhe një dekadë pas nënshkrimit të saj, Maqedonia akoma nuk funksionon si një shoqëri multietnike e multikulturore, ku pjesëtarët e të gjitha etniteteve të ndjehen të barabartë dhe të përfaqësuar drejt nëpër institucione.

Por pas Amandamenteve të njëpasnjëshme të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të drejtat e etniteteve u afirmuan më shumë.

Tani pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë që lirisht t’i shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale. Republika ua garanton kombësive mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre. Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë në mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhën e kombësisë, mësohet edhe gjuha maqedonase.

---

<sup>110</sup> Biljana Belamaric, “*Attempting to Resolve an Ethnic Conflict: The Language of the 2001 Macedonian Constitution*”, Southeast European Politics, Vol. IV, No. 1, May 2003 pp. 25-40

<sup>111</sup> Neni 48 i Kushtetutës 2001. *Ustav na Republika Makedonija, 2001*

<sup>112</sup> Neni 7. *Ustav na Republika Makedonija, 2001*, op. cit.

<sup>113</sup> Arend Lipjhart, “*Constitutional designs for divided societies*”, Journal of Democracy, 15(2), 2004, ff. 96- 114



Gjithashtu në seancën e 93 - të, të mbajtur më 8 tetor 2018, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut u pajtua me nevojën për të hartuar një Strategji Kombëtare për Zhvillimin e Konceptit të Një Shoqërie Ndërkulturore. Përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë është në përputhje me programin e Qeverisë, si dhe me prioritetet strategjike të Qeverisë për vitin 2020. Qëllimi i saj është të përmirësoj komunikimin ndërkulturor në Republikën e Maqedonisë së Veriut midis kulturave dhe komuniteteve të ndryshme, si dhe përmes saj, për të zbatuar rekomandimet e organeve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian dhe Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë.<sup>115</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Konceptit të Një Shoqërie Ndërkulturore është një dokument i përgatitur për herë të parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është i një rëndësie të veçantë, duke pasur parasysh ndarjen e shoqërisë në baza të ndryshme. Ky dokument i planifikimit strategjik duhet të inicojë aktivitete dhe të forcojë proceset e komunikimit dhe bashkëpunimit mes komuniteteve në mënyrë që të krijojë një shoqëri në të cilën të gjithë do të ndihen si anëtarë të një shoqërie. Qëllimi kryesor është promovimi nga një shoqëri e ndarë në një shoqëri që është e drejtë dhe e barabartë dhe i bën qytetarët më të barabartë.<sup>116</sup>

### 4.3. Përdorimi i gjuhëve nga etnitetet në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Vetë gjuha mund të trajtohet e definohet nga këndvështrime të ndryshme: si fenomen biopsikik i shqiptimit të tingujve, si fenomen etnologjik dhe si element i trashëgimisë kulturore, si fenomen sociologjik i ndërkomunikimit dhe shfaqjes së ideve, ndjenjave dhe kuptimit me anë të mjeteve gjuhësore të cilat kanë veti të domethënies e të kuptimit të përgjithshëm gjatë përdorimit shoqëror dhe kulturor, por edhe veti të esteriorizimit të së sotmes dhe njërin prej ideve lidhëse të njeriut për botën, si fenomen i psikologjisë individuale dhe shoqërore, përkatësisht si faktor i pazëvendësueshëm i njërit prej proceseve më të larta psikologjike diskursive dhe

<sup>114</sup> *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, neni 48.

<sup>115</sup> Strategjia shtetërore për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit.

<sup>116</sup> *Raporti i Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi Raundin e Pestë të Vëzhgimit sipas Konventës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të Këshillit të Evropës*, më shumë shih: [Te drejtat e komuniteteve ne RMV.pdf](#).

strukture të “Mendimit”<sup>117</sup> dhe si faktor i pazëvendësueshëm sheshimit prej një vetëdije në vetëdijen tjetër, etj. Meqenëse këtu po e trajtojmë çështjen e gjuhës, e cila lidhet drejtpërdrejt me njëri-njëri prej kategorive kombëtare siç janë pakicat, është e natyrshme që në shqyrtimin tonë konkret t’i qasemi gjuhës nga këndvështrimi i kategorisë së rëndësisë kombëtare.

Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen. Dokumentet personale të qytetarëve, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe alfabetin e saj në përputhje me ligjin.<sup>118</sup> Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.<sup>119</sup> Për zbatimin e ligjit për gjuhët do të jenë përgjegjëse Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve dhe Inspektoriati për Përdorimin e Gjuhëve.<sup>120</sup> Për moszbatim të ligjit janë paraparë edhe gjopa për institucionet nga 4 deri në 5 mijë euro. Gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, të gjitha institucionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të obliguara t’i zbatojnë obligimet e ligjit.

Po ashtu edhe në pushtetin lokal e drejta e përdorimit të gjuhës realizohet në mënyrën që vijon: Në njësitë e pushtetit lokal në të cilat gjuha dhe alfabeti që përdorin minimum 20% i qytetarëve është gjuhë zyrtare përkrah maqedonishtes dhe alfabetit të saj cirilik (Amendamenti V), me atë që për përdorim të gjuhës dhe alfabetin që flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e pushtetit lokal vendosin organet e njësive të pushtetit lokal.<sup>121</sup>

Shqiptarëve në Maqedoni për një kohë të gjatë iu mohua përdorimi i gjuhës nëpër institucione, e drejta e arsimit të lartë në gjuhën e tyre amtare, përdorimi i flamurit kombëtar,

---

<sup>117</sup> “*Idetë nuk janë të ndara nga gjuha*” – Marks (Marks i Engels: O umetnosti I književnosti – misao i jezik).

<sup>118</sup> *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Amendamenti V.

<sup>119</sup> *Ligji për përdorimin e gjuhëve*, neni 1, paragrafi 4.

<sup>120</sup> *Ligji për Inspektoriatin e gjuhëve*.

<sup>121</sup> *Ligji për vetëqeverisje lokale*, neni 41, paragrafi 3.

madje shpesh u përdor dhunë për pengimin e ushtrimit të këtyre të drejtave jetike.<sup>122</sup>

Se sa është e sa nuk është zyrtare gjuha shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është folur, diskutuar dhe shkruar mjaft, sidomos pas pavarësimit të Maqedonisë, e veçanërisht pas ndryshimeve Kushtetuese të cilat janë bazuar në principet e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001. Mirëpo, për fat të keq, edhe me këto amandamentime të Kushtetutës, gjuha shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk u bë kategori kushtetuese, por u emërtua si “gjuhë që e flasin më shumë se 20% e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.<sup>123</sup> Identitetet e ndryshme etnike nuk janë artificialisht të krijuara andaj nuk duhet që të injorohen. Gjuha, shkrimi, religjioni, kultura, simbolet janë shumë të rëndësishme për njerëzit sepse flasin për identitetin e tyre.<sup>124</sup> Edhe krahas progresit të arritur, akoma ekzistojnë tensione ndëretnike dhe mungesë e besimit të ndërsjellë, veçanërisht në nivel lokal.<sup>125</sup>

#### **4.4. Parashtrësats individuale të Avokatit të Popullit**

Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe krahasimi i tyre për nga përkatësia etnike.

##### *Statistikat e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës:*

Nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2020, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar nga qytetarët e Kosovës 1419 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo për ndihmë juridike. Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, kishin të bënin me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, mbrojtjen e pronës, barazinë para ligjit, të drejtën e qasjes në dokumente publike etj.

---

<sup>122</sup> *Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit - A funksionon Maqedonia si shtet multietnik*, Tetovë, 2011, fq.93.

<sup>123</sup> <https://gazetadielli.com/sa-nuk-eshte-zyrtare-gjuha-shqipe-ne-republiken-e-maqedonise-se-veriut/>, çasja e fundit më datën 10.08.2021 në ora 2:04.

<sup>124</sup> Mirjana Maleska, Lidija Hristova, “*Spodeluvanje na vlasta vo multikulturnite opstini vo Republika Makedonija*”, Godisnik na institutot za socioloski i politiko-pravni istrazuvanja, Univerzitet “Sv. Kiril i Metodij” – Shkup, Viti XXXI, nr. 1, Shkup, 2006, f. 100

<sup>125</sup> *Strategji për Maqedoninë e Veriut 2019-2024*, Miratuar nga Këshilli i drejtorëve më 22 maj 2019, fq. 26.

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura dhe i rasteve të hetuara, numri i rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare, përkatësia etnike e ankuesve, gjinia e ankuesve, numri i rasteve të zgjidhura, autoritetet përgjegjëse kundër të cilave janë drejtuar ankesat, numri i raporteve me rekomandime dhe i letrave me rekomandime për rastet e hetuara, opinioneve, kërkesave për masë të përkohshme etj.

126

Tabela 1: Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2020.

	<b>Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP</b>	1419
	Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura	11197
<b>Përk atësia etnike e ankuesve</b>		
	Shqiptarë	1270
	Serbë	64
	Boshnjakë	24
	Ashkalinj	18
	Turq	15
	Romë	14
	Egjiptianë	5
	Goranë	4
	Të tjerë	5
<b>Gjinia e ankuesve</b>		
	Meshkuj	1016
	Femra	403

<sup>126</sup> RAPORTI VJETOR 2020 Nr. 20, më shumë shih: [raporti 2020.pdf](#), fq. 160.

Tabela 2: Rastet e hapura për hetim nga IAP – ja gjatë vitit 2020.

<b><i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i></b>		
	Shqiptarë	627
	Serbë	47
	Boshnjakë	17
	Turq	10
	Ashkalinj	5
	Egjiptianë	3
	Romë	3
	Goranë	3
	Të tjerë	5
<b><i>Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara</i></b>		
	Meshkuj	521
	Femra	199

Për shkak që Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk e ka publikuar ende raportin për vitin 2020 unë do ta analizoj raportin e vitit 2019, me raportin e vitit 2020 të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

*Statistikat e Institucionit të Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut:*

Në vitin raportues Avokati i Popullit veproi për gjithsej 4.705 parashtresa, nga të cilat 3.453 nga periudha raportuese, ndërsa 1.252 të tjera janë bartur nga viti paraparak. Numri më i madh i parashtresave 2.158 u dorëzuan personalisht nga parashtruesit në zyrat e Avokatit të Popullit, përmes postës 605, postës elektronike 313, përmes web-faqes 268, përmes paraqitjes me telefon 70, përmes telefaksit 2, ndërsa 37 parashtresa u formuan sipas iniciativës personale.

Nga numri i përgjithshëm i parashtrësive të pranuar në vitin 2019, numri më i madh 1.455 ose 42,14% kanë të bëjnë me cënimin e të drejtave nga ana e shërbimeve dhe institucioneve publike, 1.104 ose 31,97% kanë të bëjnë me cënimin e të drejtave nga ana e pushtetit qendror, në 356 parashtrësia ose 10,31% janë cënime të të drejtave nga ana e pushtetit lokal, në 215 parashtrësia ose 6,23% janë cënime të të drejtave nga ana e personave juridikë, në 25 parashtrësia ose 0,72% kishte cënim të të drejtave, si nga pushteti qendror ashtu edhe nga ai lokal, ndërsa në 298 parashtrësia ose 8,63% parashtruesit e parashtrësive janë ankuar për cënimin e të drejtave nga subjekte tjera.<sup>127</sup>

---

<sup>127</sup> *RAPORT VJETOR 2019*, më shumë shih: [Raporti 2019 Maqedoni.pdf](#), fq. 155.

Kjo tabel tregon pasqyrën e parashtruesve të parashtrësive në bazë të përkatësisë etnike sipas fushave.

## RAPORT VJETOR

### Pasqyra nr.2

FUSHA	Të pranuar në vitin 2019	PËRKATËSIA ETNIKE													
		Anonime	Numri i iendëve të formuara me iniciativë personale	Organizata (Shoqata)	Numri i parashtruesve	Maqedonas	Shqiptarë	Serbë	Romë	Maqedonas-Mysliman	Boshnjakë	Vlleh	Turq	Nuk e kanë deklaruar përkatësinë etnike	Të tjerë
Mosdiskrimini dhe përfaqësimi i drejtë dhe adekuat	60		1	6	53	20	3	2	2		1		25		
Autorizime policore	170	1	1	8	213	104	17	1	2	1		4	84		
Gjendje civile dhe punë tjera të rendit	70		1	12	58	11	12		3	2	1	1	25	3	
Jurisprudenca	639	2		12	636	223	95	5	11	3	1	2	18	276	2
Prokuroria	63			6	57	31	5		1			2	18		
Mbrojtja dhe siguria sociale	159		2	2	155	34	63		19	2	1	5	29	2	
Marrëdhëniet e punës	282	3	1	15	321	100	23	2		1		1	194		
Çështje të banimit	17	1		1	63	5			1	1			55	1	
Mbrojtja shëndetësore	106		4	1	100	16	9		45			5	25		
Sigurimi pensional dhe invalidor	146			2	163	57	25		3			5	73		
Arsimi, shkenca	20			1	24	7	8						9		
Kultura dhe sporti	2				2		2								
Të drejtat e fëmijëve	246		9	12	244	68	5	1	7	2	1		158	2	
Urbanizmi dhe ndërtimi	185	2		12	270	70	12		1	1	1	7	178		
Mjedisi jetësor	18	1	1		17	4	2			1		1	9		
Financat	137	2		6	133	64	19		6	2		2	39	1	
Marrëdhëniet pronësore-juridike	188			13	184	73	15	1				8	87		
Të drejtat e konsumatorëve	367	1	2	7	408	193	46	3	9	1	4	1	8	141	2
Entet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese	267	1	12	10	254	7	31		8	1	1	2	204		
Persona me nevoja të veçanta	24		2	7	14	3	1				2		8		
AP si mik i gjykatës	5			2	3	1							2		
Të drejtat zgjedhore	54			8	45	9							36		
Të tjera	228	3	1	15	634	69	28		4	3	377	1	149	3	
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>3453</b>	<b>17</b>	<b>37</b>	<b>158</b>	<b>4051</b>	<b>1169</b>	<b>421</b>	<b>15</b>	<b>122</b>	<b>10</b>	<b>18</b>	<b>386</b>	<b>70</b>	<b>1824</b>	<b>16</b>

Figure 2 Raporti vjetor – 2019, Shkup, fq. 157.

Nga numri i përgjithshëm i parashtruesve të parashtrësive 54,97% ose 2.227 qytetarë e kanë deklaruar përkatësinë e tyre etnike, ndërsa 1.824 ose 45,03% nuk e kanë deklaruar, e që krahasuar me vitin paraprak është gjendje përafërsisht e njëjtë. Së këtejmi, numri më i madh i qytetarëve, të cilët janë deklaruar si maqedonas 1.169 ose 52,49%, 421 ose 18,90% janë pjesëtarë të bashkësisë etnike shqiptare, 386 ose 17,33% janë pjesëtarë të bashkësisë etnike vllehe; 122 ose 5,48% janë pjesëtarë të bashkësisë etnike rome; 70 ose 3,14 % janë pjesëtarë të bashkësisë etnike turke; 18 ose 0,81% janë prononcuar si boshnjakë; 16 ose 0,72% janë pjesëtarë të bashkësive të tjera etnike, 15 ose 0,67% janë serb, ndërsa numri më i vogël i parashtrësive 10 ose 0,45% janë qytetarë parashtrues të cilët janë deklaruar si maqedonas myslimanë.

Krahasuar me vitin e kaluar shënohet rritje e numrit të qytetarëve të cilët e kanë deklaruar përkatësinë e tyre etnike të çdo bashkësie etnike e që në mënyrë evidente shihet tek pjesëtarët e bashkësisë etnike maqedonase dhe vllehe.<sup>128</sup>


---

<sup>128</sup> Po aty, fq. 158.




## Hulumtimi empirik

Hulumtimi empirik është i përbërë nga 14 pyetje, të cilat janë plotësuar në mënyrë elektronike me anë të një pyetësi të formuluar nga aplikacioni Google Forms. Pyetjet janë të tipit të mbyllur më mundësi zgjedhje të njërës opcioni. Në plotësimin e këtij pyetësi kanë marrë pjesë 370 anketues të gjinive, moshave, nivelit të edukimit dhe kombësive të ndryshme.



**Diagrami nr. 1: Raporti femra dhe meshkuj.**

Në hulumtimin tonë kanë marrë pjesë 370 anketues, ku prej tyre 148 persona ose 40% janë femra dhe 222 persona ose 60% janë meshkuj.




## Diagrami nr. 2: Moshë në të cilën janë marrë të anketuesit.

Në këtë diagram janë rezultatet e moshave të pjesëmarrësve në hulumtim:

140 persona ose 37.8% e anketuesve i takojnë moshës 18-24 vjeç;

195 persona ose 52.7% e anketuesve i takojnë moshës 24-40 vjeç;

26 persona ose 12.3% e anketuesve i takojnë moshës 40-60 vjeç.



## Diagrami nr. 3: Niveli i arsimimit të anketuesve.


Në diagramin numër 3 kam paraqitur nivelin e edukimit të anketuesve ku kam nxjerrë këto të dhëna:

*Niveli i mesëm i shkollimit:* 96 persona ose 26.5% e anketuesve;

*Niveli Bachelor:* 177 persona ose 47.8% e anketuesve;

*Niveli Master:* 85 persona ose 23% e anketuesve;

*Doktoraturë:* 10 persona ose 2.7% e anketuesve.




**Diagrami nr. 4: Shkelja e të drejtave nga vendimet e autoriteteve publike.**

Në pyetjen: *A janë shkelur të drejtat e juaja nga ndonjë vendim i autoriteteve publike?*  
Anketuesit kanë pasur të drejtë të zgjedhin dy mundësi, *po* ose *jo*:

Alternativën *Po* e kanë zgjedhur 172 persona apo 46.5% e anketuesve;

Alternativën *Jo* e kanë zgjedhur 198 persona apo 53% e anketuesve.




#### Diagrami nr.4: Shërbimet e ofruara nga Administrata Shtetërore në Republikën e Kosovës.

Në pyetjen: *A jeni të kënaqur me punën dhe shërbimet e Administratës Shtetërore në Republikën e Kosovës?* Anketuesit janë përgjigjur kështu:

*Shumë të kënaqur:* kanë rezultuar të jenë 22 persona apo 5.9% e anketuesve;

*Realitivist të kënaqur:* kanë rezultuar të jenë 279 persona apo 75.4% e anketuesve;

*Aspak të kënaqur:* kanë rezultuar të jenë 69 persona apo 18.6% e anketuesve.



#### Diagrami nr. 5: Respektimi i të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës

Në pyetjen: *A respektohen të drejtat e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës?* Anketuesit janë përgjigjur kështu:


*Shumë:* 166 persona ose 44.9% e anketuesve;

*Pak:* 190 persona apo 51.4% e anketuesve;

*Aspak:* 14 persona apo 3.8% e anketuesve.

Të drejtat e të cilit komunitet jo shumicë respektohen më shumë në Republikën e Kosovës?

370 responses



**Diagrami nr. 6: Komuniteti me i respektuar në Republikën e Kosovës.**

Në pyetjen: *Të drejtat e të cilit komunitet jo shumicë respektohen më shumë në Republikën e Kosovës?* Kam marrë këto rezultate:

*Serb:* 253 persona apo 68.4% e anketuesve;

*Turk:* 62 persona apo 16.8% e anketuesve;

*Boshnjak:* 10 persona ose 2.7% e anketuesve;

*Rom:* 20 persona ose 2.4% e anketuesve;


*Ashkali:* 15 persona ose 4.1% e anketuesve;

*Egjiptian:* 6 persona ose 1.9% e anketuesve;

*Goran:* 4 persona ose 1.1% e anketuesve.

Të drejtat e të cilit etnitet respektohen më shumë në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

144 responses



**Diagrami nr. 7: Etniteti më i respektuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Në pyetjen: *Të drejtat e të cilit etnitet respektohen më shumë në Republikën e Maqedonisë së Veriut?* Anketuesit janë përgjigjur kështu:

*Maqedonas*: 105 persona ose 72.9% e anketuesve;


*Shqiptar*: 18 persona ose 12.5% e anketuesve;

*Turk*: 5 persona ose 3.5% e anketuesve;

*Vlleh*: 0 persona ose 0% e anketuesve;

*Romë*: 2 persona ose 1.4% e anketuesve;

*Të tjerë*: 14 persona ose 9.7% e anketuesve.




**Diagrami nr. 8: Ballafaqimi me zyrën e Avokatit të Popullit.**

Në pyetjen: *A jeni ballafaquar me zyrën e Avokatit të Popullit?* Kam marrë këto rezultate:

Alternativën *Po* e kanë zgjedhur 21 persona ose 5.7% e anketuesve;

Alternativën *Jo* e kanë zgjedhur 349 persona ose 94.3% e anketuesve.




**Diagrami nr. 9: Dobishmëria e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.**

Pyetjes: *Sa jeni të kënaqur me punën e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës?* Anketuesit i janë përgjigjur kështu:

*Shumë të kënaqur*: 26 persona ose 7% e anketuesve;

*Realitivisht të kënaqur*: 266 persona ose 71.9% e anketuesve;

*Aspak të kënaqur: 78 persona ose 21% e anketuesve.*



**Diagrami nr. 10: Transpareca e Instutucionit të Avokatit të Popullit.**


Pyetjes: *A dyshoni tek transpareca e Institucionit të Avokatit të Popullit?* Anketuesit i janë përgjigjur kështu:

*Po:* 92 persona ose 24.9% e anketuesve;

*Jo:* 87 persona ose 23.5% e anketuesve;

*Me raste:* 191 persona ose 51.6% e anketuesve.





**Diagrami nr. 11: Praktika e punës së Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës.**

Pyetjes: *Sa e njihni praktikën e punës së Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës?*


Anketuesit i janë përgjigjur kështu:

*Shumë:* 32 persona ose 8.6% e anketuesve;

*Pak:* 249 persona ose 67.3% e anketuesve;

*Aspak:* 67 persona ose 18.1% e anketuesve;

*Nga përvoja personale:* 22 persona ose 5.9% e anketuesve.



**Diagrami nr. 12: Shërbimet e Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

Pyetjes: *Sa jeni të njohur me punën e zyrës së Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut?* Anketuesit i janë përgjigjur kështu:

*Shumë:* 7 persona ose 1.9% e anketuesve;


*Pak:* 136 persona ose 36.8% e anketuesve;

*Aspak:* 220 persona ose 59.5% e anketuesve;

*Nga përvoja personale:* 7 persona ose 1.9% e anketuesve.

Sa i besoni zyrës së Avokatit të Popullit si autoritet i mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve në përgjithësi?

370 responses



**Diagrami nr. 13: Besueshmëria e Avokatit të Popullit si autoritet i mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve në përgjithësi.**

Pyetje: *Sa i besoni zyrës së Avokatit të Popullit si autoritet i mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve në përgjithësi?* Anketuesit janë përgjigjur kështu:

*I besoj:* 87 persona ose 23.5% e anketuesve;

*Nuk i besoj:* 45 persona ose 12.2% e anketuesve;

*Është i ndikuar politikisht:* 125 persona ose 33.8% e anketuesve;

*Ka procese të vonuara:* 88 persona ose 23.8% e anketuesve;

*Zgjidh procese të zvaritura:* 25 persona ose 6.8% e anketuesve.

## **Rekomandimet**

Me qëllim që të sigurohet mbrojtje më e mirë e të drejtave të njeriut dhe zbatim efikas i ligjeve ky punim diplome ofron disa rekomandime që autoritetet dhe zyrtarët e administratës publike duhet ti marrin parasysh në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e mundshme për problemet e theksuara më lartë. Rekomandimet do t'i propozoj si një mënyrë për të rregulluar mangësitë e identifikuara gjatë realizimit të punimit:

Institucioni i Avokatit të Popullit të shqyrtojë ankesa nga fëmijët dhe personat në moshë madhore lidhur me të drejtat e fëmijëve;

Përmes studimeve dhe analizave të Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të nxitet mbrojtja e fëmijëve që janë të ekspozuar ndaj kriminalitetit në rritje, arsimimit të pamjaftueshëm, varësisë nga drogat, lypjes, punës së detyruar, abuzimit dhe punës së detyruar etj;

Duhet të nxitet bashkëpunim më i madh me institucionet dhe mekanizmat ndërkombëtarë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut;

Kategorizimi dhe raportimi i rasteve të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të adresohen menjëherë;

Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të ndërhyjë në rastet kur ka zvarritje të paarsyeshme të procedurave gjyqësore në sistemin e drejtësisë;

Të respektohen rekomandimet e Hagës në lidhje me të Drejtat e Arsimit të Pakicave Kombëtare, veçanërisht në shtetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Të respektohen rekomandimet e Oslos lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare;

Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, duhet të mundohet të ndikojë në edukimin e Administratës, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj është të jetë shërbëtoare për t'u shërbyer qytetarëve që të realizojnë të drejtat e tyre;

## Përfundimet

Fillimisht, më duhet të potencoj faktin që studimi në fjalë, që i referohet funksionimit të Avokatit të Popullit, dy praktikave në mes shteteve fqinje, si rasti i Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe elementeve apo tipareve dalluese që e përbëjnë formën e funksionimit të Institucionit të Avokatit të popullit, ka bërë të mundur të nxjerrim në sipërfaqe praktika reale të cilat flasin për një nga autoritetet më kompetente të ndarjes së sistemit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe njëherit vlerave fundamentale të demokracisë.

Përveç qasjes teorike, të përmbledhur në këtë pjesë të hulumtimit shkencor, aspekteve komperative të cilat janë marrë si bazë studimi në këtë rast, na ka mundësuar t'i kuptojmë edhe tiparet dalluese të realizimit të praktikave dhe ballafaqimit të situatave të ndryshme nga një praktikë në tjetrën.

Nga ana tjetër, studimi ka marrë në konsideratë edhe raportet periodike të punës së autoriteteve të Avokatit Popullor, si dikastere shumë të rëndësishme institucionale, me të cilat kam aritur të sjell konkluzat e një devijimi të skajshëm në disa raste të të drejtave të njeriut, edhe atë bazuar në raportet e praktikës së RMV-së dhe formave të shkeljes drastike të të drejtave njerëzore. Zyra e Avokatit të popullit dhe evitimi i rasteve të këtilla ka paraqitur një situatë të rëndësishme në domenin e interevenimit dhe trajtimit institucional të rasteve të cilat kanë një prapavijë të shkeljes drastike të vlerave fundamentale njerëzore. Ajo pjesë e studimeve të rasteve praktike, na jep një pasqyrë më reale të përshkrimit të situatës dhe dhënjes së një kuptimi të përgjithshëm për atë që këto autoritete bartin mbi vete përgjegjësinë rreth shqyrtimit të rasteve me interes madhor për tu trajtuar.

Sipas anketës së realizuar qytetarët e Republikës së Kosovës nuk është që janë edhe aq të kënaqur me shërbimet e Administratës Shtetërore, por janë shumë të kënaqur në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve jo shumicë nga aparati shtetëror. Ndonëse historikisht shqiptarët e Kosovës nuk kanë pasur marrdhënie të mira me fqinjët serb, shumica e të anketuarve nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës, si komunitetin më të privilegjuar në aspektin kushtetues-juridik e kanë zgjedh komunitetin serb. Në rastin konkret për shkak të ndërlikueshmërisë së çështjes që ngërthen në vete zbërthimin e nocioneve dhe vlerave të këtij studimi gjatë realizimit të këtij studimi vërehet solidariteti, humanizmi dhe largpamësia e të gjithë atyre që kanë punuar në garantimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse garantimi i të drejtave elementare të njeriut në një shtet multi-etnik siç është Republika e Kosovës është parakusht për mirqenje sociale.

Për dallim nga fqinjët e tyre, Republika e Maqedonisë së Veriut si shtet multi-etnik që është duhet ende të punojë në fuqizimin, avancimin dhe integrimin e etniteteve në aspektin kushtetues-juridik sepse garantimi dhe respektimi të drejtave të njeriut në veçanti respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare apo etniteteve tjera jo shumicë është standard evropian dhe parakusht për synimet euro-integruese dhe euro-atlantike.

Në anën tjetër, në bazë të rezultateve për informatën kthyesë të punës së zyrës së Avokatit në mes praktikave të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, të anketuarit shprehen kështu:

Disa prej pyetjeve të parashtruara në anketë janë këto:

*- A janë shkelur të drejtat e juaja nga ndonjë vendim i autoriteteve publike?*

Po janë përgjigjur 172 persona apo 46.5% e anketuesve ndërsa, Jo janë përgjigjur 198 persona apo 53% e anketuesve.

*A janë shkelur të drejtat e juaja nga ndonjë vendim i autoriteteve publike?*

Shumë të kënaqur kanë rezultuar të jenë 279 persona apo 5.9% e anketuesve, Relativisht të kënaqur kanë rezultuar të jenë 279 persona apo 75.5% e anketuesve, Aspak të kënaqur kanë rezultuar të jenë 69 persona apo 18.6 e anketuesve.

*A respektohen të drejtat e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës?*

Shumë janë përgjigjur 166 persona ose 44.9% e anketuesve, Pak janë përgjigjur 190 persona ose 51,4% e anketuesve, Aspak janë përgjigjur 14 persona ose 3.8% e anketuesve

*Të drejtat e të cilit komunitet jo shumicë respektohen më shumë në Republikën e Kosovës?*

Në këtë pyetje anketuesit janë përgjigjur kështu: Serb 253 persona apo 68.4% e anketuesve, Turk 62 persona ose 16.8% e anketuesve, Boshnjak 10 persona ose 2.4% e anketuesve, Ashkali 15 persona ose 4.1% e anketuesve, Egjiptian 6 persona ose 1.9% e anketuesve, Goran 4 persona ose 1.1% e anketuesve

*Të drejtat e të cilit etnitet respektohen më shumë në Republikën e Maqedonisë së Veriut?*

Në këtë pyetje anketuesit janë përgjigjur kështu: Maqedonas janë përgjigjur 105 persona ose 72.9% e anketuesve, Shqiptar 18 persona ose 3,5% e anketuesve, Vlleh 0 persona ose 0% e anketuesve, Romë 2 persona ose 1,4% e anketuesve, ndërsa me me opcionin të Tjerë janë përgjigjur 14 persona ose 9.7% e anketuesve.

*A jeni ballafaquar me zyrën e Avokatit të Popullit?*

Kam marrë këto rezultate: Po janë përgjigjur 21 persona ose 5.7% e anketuesve, ndërsa Jo janë përgjigjur 349 persona ose 94.3% e anketuesve.

*Sa jeni të kënaqur me punën e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës?*

Në këtë pyetje Shumë të kënaqur janë përgjigjur 26 persona ose 7% e anketuesve, Relativisht të kënaqur janë përgjigjur 26 persona ose 7% e anketuesve, Aspak të kënaqur janë përgjigjur 78 persona ose 21% e anketuesve.

*A dyshoni tek transpareca e Institucionit të Avokatit të Popullit?*

Po janë përgjigjur 92 persona ose 24.9% e anketuesve ndërsa Jo janë përgjigjur 87 persona ose 23.5% e anketuesve, Me raste janë përgjigjur 191 persona ose 51.6% e anketuesve.

*Sa e njihni praktikën e punës së Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës?*

Shumë janë përgjigjur 32 persona ose 8.6% e anketuesve, Pak janë përgjigjur 249 persona ose 67.3% e anketuesve, Aspak janë përgjigjur 67 persona ose 18.1% e anketuesve dhe me opcionin Nga përvoja personale janë përgjigjur 22 persona ose 5.9% e anketuesve.

*Sa jeni të njohur me punën e zyrës së Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut?*

Shumë janë përgjigjur 7 persona ose 1.9% e anketuesve, Pak janë përgjigjur 136 persona ose 36.8% e anketuesve, Aspak janë përgjigjur 220 persona ose 59.5% e anketuesve, Nga përvoja personale janë përgjigjur 7 persona ose 1.9% e anketuesve.

*Sa i besoni zyrës së Avokatit të Popullit si autoritet i mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve në përgjithësi?*

I besoj janë përgjigjur 87 persona ose 23.5% e anketuesve, Nuk i besoj janë përgjigjur 45 persona ose 12.2% e anketuesve, Është i ndikuar politikisht janë përgjigjur 125 persona ose 33.8% e anketuesve, Ka procese të vonuara 88 persona ose 23.8% e anketuesve, Zgjidh procese të zvarritura 25 persona ose 6.8% e anketuesve.

Nga ky studim, kemi arritur të identifikojmë faktet se tek këto institucione me relevancë të jashtëzakonshme në sendërtimin e vlerave të sistemit të mirëfilltë demokratik siç janë autoritetet e zyrës së Avokatit të Popullit, të cilat intenzivisht punojnë fort për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve, pa dallim përkatësie etnike, besimi fetar e statusi shoqëror, mbi të gjitha kanë një mision të përbashkët. Ta mbrojnë interesin e qytetarit e të punojnë bindshëm që tek këto institucione të ketë besim. Sendërtimi i krijimit të besimit insitucional, është sfida e dy vendeve, si një sfidë e cila duhet paralelisht të ndiqet nga këto autoritete institucionale. Ky në fakt do të ishte edhe prezantim i një imazhi të shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së vlerave fundamentale të demokracisë së mirëfilltë në një shtet dhe në një shoqëri, aq më tepër, si vendet ku bëjmë pjesë



edhe ne, ku duhet këto institucione të forcohen edhe më shumë për të qenë më afër aspiratave të arritjes së statusit, vend anëtar në BE.

## **Conclusion**

First of all, I must emphasize the fact that the study in question, which refers to the functioning of the People's Advocate, two practices between neighboring countries, such as the case of the Republic of Kosovo and the Republic of Northern Macedonia and the distinctive elements or features that make up the form of The functioning of the Ombudsman Institution has made it possible to bring to the surface real practices which speak of one of the most competent authorities for the division of the legal system and the protection of human rights and at the same time the fundamental values of democracy.

In addition to the theoretical approach, summarized in this part of scientific research, comparative aspects which are taken as the basis of study in this case, has enabled us to understand the distinctive features of the realization of practices and dealing with different situations from one practice to another.

On the other hand, the study has taken into account the periodic reports of the work of the authorities of the People's Advocate, as very important institutional departments, with

which I have managed to bring the conclusions of an extreme deviation in some cases of human rights, also based on RMV practice reports and forms of drastic human rights violations. The Office of the People's Advocate and the avoidance of such cases has presented an important situation in the field of intervention and institutional treatment of cases which have a background of drastic violation of fundamental human values. That part of the case studies gives us a more realistic picture of the description of the situation and gives a general understanding of what these authorities have the responsibility of reviewing cases of major interest to be dealt with.

According to the survey conducted, the citizens of the Republic of Kosovo are not so satisfied with the services of the State Administration, but are very satisfied with respect for the human rights of non-majority communities by the state apparatus. Although Kosovo Albanians have historically not had good relations with their Serb neighbors, the majority of respondents from all communities living in the Republic of Kosovo have chosen the Serb community as the most privileged community in terms of constitutionally and legally. In this case, due to the complexity of the issue that involves the analysis of the notions and values of this study during the implementation of this study, the solidarity, humanism and foresight of all those who have worked to guarantee the rights of non-majority communities in the Constitution of the Republic of Kosovo, because the guarantee of basic human rights in a multi-ethnic state such as the Republic of Kosovo is a precondition for social welfare.

Unlike their neighbors, the Republic of Northern Macedonia as a multi-ethnic state still has to work on the empowerment, advancement and integration of ethnicities in the constitutional-legal aspect because the guarantee and respect of human rights in particular the respect of The rights of national minorities or other non-majority ethnicities is a European standard and a precondition for Euro-integration and Euro-Atlantic goals.

On the other hand, based on the results of the feedback on the work of the Law Office between the practices of Kosovo and Northern Macedonia, the respondents say:

Some of the questions asked in the survey are:

*Have your rights been violated by any decision of public authorities?*

172 persons or 46.5% of the respondents answered Yes, while 198 persons or 53% of the respondents answered No.

*Have your rights been violated by any decision of public authorities?*

Very satisfied turned out to be 279 persons or 5.9% of the respondents, Relatively satisfied turned out to be 279 persons or 75.8% of the respondents, Not at all satisfied turned out to be 69 persons or 18.6 of the respondents.

*Are the rights of non-majority communities respected in the Republic of Kosovo?*

166 persons or 44.9% of the respondents answered a lot, 190 persons or 51.4% of the respondents answered a little, 14 persons or 3.8% of the respondents did not answer at all

*Which non-majority community rights are most respected in the Republic of Kosovo?*

To this question the respondents answered as follows: Serb 253 persons or 68.4% of the respondents, Turk 62 persons or 16.8% of the respondents, Bosniak 10 persons or 2.4% of the respondents, Ashkali 15 persons or 4.1% of the respondents, Egyptian 6 persons or 1.9% of respondents, Goran 4 persons or 1.1% of respondents

*Whose ethnic rights are most respected in the Republic of Northern Macedonia?*

To this question the respondents answered as follows: 105 persons answered Macedonians or 72.9% of the respondents, Albanians 18 persons or 3.5% of the respondents, Vlachs 0 persons or 0% of the respondents, Roma 2 persons or 1.4% of the respondents, while with the Other option 14 persons or 9.7% of the respondents answered.

*Have you faced the office of the People's Advocate?*

I received the following results: Yes answered 21 persons or 5.7% of respondents, while No answered 349 persons or 94.3% of respondents.

*How satisfied are you with the work of the People's Advocate in the Republic of Kosovo?*

26 persons or 7% of the respondents answered this question Very satisfied, 26 persons or 7% of the respondents answered Relatively satisfied, 78 persons or 21% of the respondents did not answer at all.

*Do you doubt the transparency of the People's Advocate Institution?*

92 persons or 24.9% of the respondents answered Yes, while 87 persons or 23.5% of the respondents answered No, 191 persons or 51.6% of the respondents answered in cases.

*How much do you know about the work practice of the People's Advocate in the Republic of Kosovo?*

Many answered 32 persons or 8.6% of the respondents, Few answered 249 persons or 67.3% of the respondents, 67 persons or 18.1% of the respondents did not answer at all and with the option From personal experience 22 persons or 5.9% of the respondents answered.

*How familiar are you with the work of the ombudsman's office in the Republic of Northern Macedonia?*

Many answered 7 persons or 1.9% of the respondents, Few answered 136 persons or 36.8% of the respondents, 220 persons or 59.5% of the respondents did not answer at all, From personal experience 7 persons or 1.9% of the respondents answered.

*How much do you trust the ombudsman's office as an authority to protect the rights of citizens in general?*

I believe 87 people or 23.5% of the respondents answered, I do not believe 45 people or 12.2% of the respondents answered, 125 people or 33.8% of the respondents are politically influenced, 88 people or 23.8% of the respondents have delayed processes , Select processes dragging 25 people or 6.8% of respondents.

From this study, we have managed to identify the facts that in these institutions with extraordinary relevance in the realization of the values of a genuine democratic system such as the authorities of the Office of the People's Advocate, which work intensively to protect the rights of citizens, without ethnicity, religion and social status all have a common mission. To

protect the interest of the citizen and to work convincingly to have trust in these institutions. Realizing the creation of institutional trust is the challenge of the two countries, as a challenge which must be pursued in parallel by these institutional authorities. This would in fact be a presentation of an image of the rule of law and the protection of the fundamental values of genuine democracy in a state and a society, especially as the countries where we belong and where these institutions should be strengthened. more to be closer to the aspirations of achieving EU member state status.

## **Bibliografia**

1. Esat Stavileci, “*Hyrje në shkencat administrative*”, Prishtinë, 1997.
2. Esat Stavileci, “*Nocione dhe parime të administratës publike*”, Prishtinë, 2007.
3. Ermir Dobjani, “*E drejta Administrative 1*”, Tiranë, 2007.
4. Sadushi, Sokol, “*E drejta administrative 2*”, Tiranë, 2008.
5. A. Sokoli, “*E drejta administrative*”, Prishtinë, 2014.
6. Kadri Kryeziu, “*E drejta administrative*”, Prizren, 2019.
7. Arsim Bajrami, “*Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*”, Prishtinë, 2014.

8. Bajram Pollozhani, Ermir Dobjani, Esat Stavileci, Lazim Salihu, “*E Drejta Administrative*” - Aspekte krahasuese, Shkup, 2010.
9. Zejnullah Gruda, “*Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*”, Prishtinë, 2010.
10. Zeqirja Rexhepi, “*Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990-2001*”, Tetovë, 2005.
11. Donald Rowat, “*The ombudsman, Citizens Defender*”, London 1965.
12. Ana Pavlova – Daneva, “*Ombudsman*”, Shkup, 2000.
13. Srgjan Kerim, “*Urat e së ardhmes*”, Tiranë: Ideart, 2006.
14. “*Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit - A funksionon Maqedonia si shtet multietnik*”, Tetovë, 2011.
15. Biljana Belamaric, “*Attempting to Resolve an Ethnic Conflict: The Language of the 2001 Macedonian Constitution*”, Southeast European Politics, Vol. IV, No. 1, May 2003.
16. Aristoteli, “*Politika*”, Libri i parë, Kapitulli i dytë, 4.
17. Laurience C. Ekhlundh, “*Sistemi Parlamentar Suedez i Avokatit të Popullit*” në Komisionet për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrat e Avokatit të Popullit.
18. Jadranka Denkova, “*Roli i Avokatit të Popullit në Republikën e Maqedonisë si kontrollues i punës së administratës shtetërore*”, 2016.
19. “*Idetë nuk janë të ndara nga gjuha*” – Marksi.
20. “*Deklaratë për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë*”, Flaka e vëllazërimit, Shkup: 27 janar 1991.
21. Linda C. Reif, “*The Ombudsman, Good Governance and the International Human Rights System*”.
22. Arend Lijphart, “*Dizajni kushtetues për shoqëritë e ndara*”, Gazeta e Demokracisë, 2004.
23. “*Raporti në hije për kapitullin 23*”, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, Instituti për Politik Evropiane, Shkup.
24. Mes veprimet dhe mosveprimet – *Reformat në kapitullin e 23, i hartuar nga Instituti për Politikë Evropiane* – Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.
25. “*Pakoja e Ahtisarit*”, 2007.
26. “*Gjendja e Kornizës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë*”, Nëntor, 2017.

27. Ali Pajaziti, *“Demokracia iliberale dhe etatizmi kulturor kundër GEIST-it multiculturalist”*.
28. Mirjana Maleska, Lidija Hristova, *“Spodeluvanje na vlasta vo multikulturните opstini vo Republika Makedonija”*, Godisnik na institutot za socioloski i politiko-pravni istrazuvanja, Univerzitet “Sv. Kiril i Metodij” – Shkup, Viti XXXI, nr. 1, Shkup, 2006.
29. Strategjia shtetërore për zhvillimin e konceptit për një shoqëri dhe interkulturalizmit, version 2, korrik, 2019.
30. Z. Wm. Hamilton, *“Komentari nr. 16: Jugosllavia: Shtetet, kombësitë dhe kombësitë e tjera”*, dhjetor, 1991.
31. Natacha Andonovski, *“Les Albanais de Macédoine: perspectives et limites d’une double identité”* në Christophe Chiclet et Bernard Lory (ed.) *“La République de Macédoine”*, Paris, 1998.
32. *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2017-2021*.
33. CIA, *“The World Factbook”*.
34. *“Marrëveshja e Ohrit”*, 13, 08. 2001.
35. *New short Oxford English Dictionary*.
36. Këshilli i Evropës, Mbështetja ndaj implementimit të reformave dhe standardeve mbi të drejtat evropiane të njeriut për institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, Strasburg, 2017.
37. Rezume përfundimtare: *“Raportimi i monitorimit të punës së Avokatit të Popullit me fokus të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi”* – 2010-2019.
38. *Strategji për Maqedoninë e Veriut 2019-2024*, Miratuar nga Këshilli i drejtorëve më 22 maj 2019.
39. *Raporti i Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi Raundin e Pestë të Vëzhgimit sipas Konventës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të Këshillit të Evropës*.
40. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*.
41. *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*.

42. *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Amandamenti V.
43. *Raporti vjetor – Për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit*, Tiranë, 2019.
44. *Raporti vjetor i Avokatit të Popullit – 2018*, Prishtinë, 2019.
45. *Raporti vjetor i Avokatit të Popullit - 2019*, Prishtinë, 2020.
46. *Raporti vjetor i Avokatit të Popullit - 2020*, Prishtinë, 2021.
47. *Raporti Vjetor në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Shkup, 2019.
48. *Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit në Republikën e Kosovës*.
49. *Ligji Nr. 05/L -020 Mbi Barazinë Gjinore*, 28 maj, 2015, Prishtinë.
50. *Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës*.
51. *Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës*.
52. *Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve* (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 99/2019).
53. *Ligji për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut*.
54. *Ligji Nr. 02/L-37 Për përdorimin e gjuhëve*.
55. *Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale*.
56. *Ligji për Avokatin e Popullit* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2003, 114/2009, 181/2016, 189/2016 dhe 35/2018).
57. *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U. nr. 111/2007 të datës 29 tetor 2008*, botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 143/2008.
58. “*Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*”, miratuar nga Këshilli i Evropës, Strasburg, 1995.
59. *Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor*.
60. *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*.
61. *Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit Racial*.
62. *Komiteti për të Drejtat e Njeriut*.
63. *Komisioni për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*.
64. *Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave*.
65. *Komisioni kundër Torturës*.



66. Komisioni për të Drejtat e Fëmijës.
67. Komisioni për Punëtorët Emigrant.
68. Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
69. Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave.
70. Protokolli Optional i Konventës kundër Torturës (OPCAT).
71. Nënkomuniteti për Parandalimin e Torturës.
72. [Portali Shtetëror i Republikës së Kosovës \(rks-gov.net\)](http://rks.gov.net).
73. [Maqedoni: Avokatit të popullit nuk i lejohet të flasë në Kuvend \(klankosova.tv\)](http://klankosova.tv).
74. <http://www.crpm.org.mk/ep-content/uploads/2018/12/The-Rule-of-Laë-in-Macedonia.pdf>
75. [SA \(NUK\) ËSHTË ZYRTARE GJUHA SHOIPE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT – Dielli | The Sun \(gazetadielli.com\)](http://gazetadielli.com).
76. [Ombudsman of the Republic of North Macedonia - ENNHRI](http://ennhri.org).
77. <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CERD/Pages/CERDIntro.aspx>.
78. [Poseben izvestaj -VPD Tetovo i Zatvor Ohrid.pdf](#).
79. [Zyra e Komisionerit për Gjuhë - Zyra e Kryeministrit të Kosovës \(rks-gov.net\)](http://rks.gov.net).